


HASAN ULQINI

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

930

2441



GRABITES  
TE  
MONUMENTEVE

930  
241

HASAN ULQINI



**GRABITES  
TE  
MONUMENTEVE**

SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»

## **EKSPLORIMI I PARË ARKEOLOGJIK I SHQIPËRISË NGA KIRIAKU I ANKONËS**

Rilindja Evropiane nxori në pah bukuritë e kulturës njerëzore të mbuluara nga errësira e Mesjetës. Poshtë shtresave të mykut shekullor u zbulua një botë e madhe, bota e antikitetit.

Ashtu siç u nxorën nga bibliotekat të pluhur të kishave dhe të manastireve veprat e shkruara në papirus dhe pergamene të filozofëve dhe të shkrimtarëve të lashtësisë, nga shtresat e tokës u nxorën qindra e qindra monumente të bukura prej mermeri, mbishkrime që tregonin për një zhvillim të madh dhe për një nivel të lartë kulture.

Shqipëria, si një pjesë e rëndësishme e kësaj treve të antikitetit, tërhoqi edhe ajo vëmendjen e mjaft udhëtarëve humanistë, që erdhën e panë të mahnitur monumentet e saj të artit klasik.

Në vitin 1418 kaloi nëpër territorin e Ilirisë së lashtë Kiriaku i Ankonës (1391-1452), antikuar dhe humanist, përkrahës i zellshëm i një koalicioni të gjerë antiosman, dëshmitar okular i bisedimeve për paqe të Adrianopolit (maj-qershor 1444), për të cilat ka lënë relacione të hollësishme.

Në tetor të vitit 1435 ai nisët përsëri nga An-kona, duke i përshkuar për herë të dytë këto brigje, të cilat i kishte vizituar 17 vjet më parë<sup>1)</sup>.

Ai vizitoi Vlorën. Shkoi në Gramata, gji deti në anën veriperëndimore të Himarës. Gramata do të thotë «i shkruar». Dhe vërtet, nëpër faqen e malit dallohen mbishkrime të shumta. Detarë dhe udhëtarë që ndalonin këtu, kur deti ishte i stuhishëm, duke pritur qetësimin e tij, gdhendnin në shkëmb emrat e tyre, duke i rrethuar me kuadrate të rregullta e të punuara me kujdes dhe mjeshtëri të posaçme, duke lënë kështu pa kuptuar copëza historie të shkruara.

Ndodhte që në Gramata ndalonin edhe priftërinj, që në këta shkëmbinj gdhendnin lutje, me anë të të cilave i kërkonin ndihmë perëndive, për të pushuar zemërimin e detit.

Kiriaku i Ankonës, që erdhi në Gramata, kopjoi disa nga këto mbishkrime që u përkisnin Dioskurësve<sup>2)</sup>. Gramatën e vizituan më vonë Leon Hëzej dhe Karl Paçi, të cilët kanë botuar disa nga këto mbishkrime, kartvizita prej guri të shkruara në vite të ndryshme, gjithmonë pas një stuhie në det.

Një mbishkrim i Gramatës bën fjalë për perandorin e Bizantit Jan Palologun (Johanes Palologos), që bëri një udhëtim në vitin 1369 nga Konstantinopoli në Avinjon të Francës, te papa Urbani V për t'i kërkuar ndihma kundër turqve osmanë<sup>3)</sup>.

Një interes të veçantë Kiriaku i Ankonës do t'i kushtojë Butrintit. Ai erdhi këtu në udhëtimin e parë, ndërsa gjatë udhëtimit të dytë qendroi dy herë ra-

---

1) Cyriaco d'Ancona. «*Inscriptiones sen epigramata graeca et latina reperta per Illyricum*», Roma MDCCXLVII. Le Bas Wadington. «*Voyage archéologique en Grèce en Asie Mineure*», Paris 1856, f. XIII-XXI. F. Pall. «*Cyriaco d'Ancona e la Crociata contro i Turchi*», «Valenij de Munte», 1937 (Bulletin historique de l'Académie roumaine) XX, f. 60.

2) Cyriaco d'Ancona, «*Inscriptiones...*», f. XIX.

3) Karl Paç. «*Gjendja ekonomike e kulturore e Shqipnis' në kohën e kalueme*», Tiranë 1925, f. 10-11.



dhazi dhe ndeshi në germadhat e disa konstruksioneve antike, pa fragmente skulpturore dhe kopjoi tre mbi-shkrime, njëri prej të cilëve bënte fjalë për lirimin e skllavit Gens Pomponio Luperko (Luperco).

Në maj të vitit 1436 Kiriaku i Ankonës gjendet në qytetin e Durrësit. Ai përshkruan muret e qytetit, flet për dy porta të kalasë, njëra lindore, tjetra perëndimore, pranë së cilës kopjoi mbishkrimin e Sulpicianit, kryepriift, prefekt, që kryente funksionet e një duumviri quiquenal (pesëvjeçar) dhe tribuni. Kiriaku i Ankonës kopjoi dhe një mbishkrim tjetër, që tani ndodhet në Muzeun Arkeologjik të Beogradit dhe shkroi për disa ledhe të fortifikuara, duke shtuar një shënim të vlefshëm për statujën e kalorësit.

*«Gjithashtu në Durrës në portën perëndimore është një statujë kalorësi e derdhur me mjeshtëri.»<sup>1)</sup>*

Kiriaku i Ankonës nuk kënaqet vetëm duke përshkruar qytetin. Ai viziton katër milje larg Durrësit një mur të vjetër, që nuk është gjë tjetër veçse fortifikimi i «Portës» që e ngatërron me transhetë ku ishte zhvilluar lufta civile në mes të Cezarit dhe të Pompeit.<sup>2)</sup> Hëzej shprehet për këtë konstatim të Kiriakut të Ankonës:

*«Duket konfuzioni pak naiv që e bëri atë (Kiriakun e Ankonës, H. U.) të marrë për transhetë e Cezarit një mur ledhi.»<sup>3)</sup>*

Më 15 qershor të po këtij viti Kiriaku i Ankonës gjendet në qytetin e Lezhës, ku sheh mure me gurë të mëdhenj dhe monumente të tjera arkitektonike të ndërtuara me art.<sup>4)</sup> Mbi një bllok të madh guri ai kopjon gjithashtu edhe një mbishkrim, që do ta gjejmë

1) Cyriaco d'Ancona «Inscriptiones...», f. XXI.

2) Cyriaco d'Ancona, «Inscriptiones...», f. XXI-XXII.

3) Leon Hezey, H. Daumet, «Mission Archeologique de Macedoine», Paris 1876, f. 355-356.

4) Cyriaco d'Ancona, «Inscriptiones...», f. XX-XXII.

më vonë të botuar edhe nga Hekardi, Muratori dhe nga Lë Bas Vadingtoni<sup>1)</sup>).

Gjithë këtë material arkeologjik të mbledhur nga Shqipëria Kiriaku i Ankonës e përshkroi në Komentaret e tij, origjinalet e të cilave janë djegur, përveç disa fletëve autografe, por ruhen mjaft të dhëna të rëndësishme të kopjuara prej miqve të tij dhe disa botimeve të ndryshme.

Me Kiriakun e Ankonës nis i pari eksplorim arkeologjik i Shqipërisë (datë që përputhet njëkohësisht me të parat eksplorime arkeologjike të Evropës). Që nga kjo kohë zë fill ai interes i madh, që do të shtohet gjatë shekujve për këtë truall të pasur me monumente të lashtësisë. Por ndërsa Kiriaku i Ankonës i përshkroi këto vlera nga interesat e një humanisti, thesarkërkues dhe arkeologë të mëvonshëm do t'i thurin interesat e tyre prej specialistësh dhe falsifikatorësh të historisë me pikësynime grabitqare dhe skllavëruese ndaj popullit tonë. Do të nisë kështu një maratonë e gjatë për t'i grabitur këtij populli objekte me vlerë të kulturës së tij, duke ia gjymtuar historinë. Por edhe pushuesit osmanë me zjarr dhe hekur bënë një shkatërrim të tmerrshëm të monumenteve të lashtësisë në Durrës, Apoloni e gjetcë.

---

1) Hyacinthe Hecquard, «*Histoire et description de la Haute Albanie au Guegarie*», Paris 1863, f. 23. L. A. Muratori, «*Novus thesaurus veterum inscriptionum*», I, Milano, 1738, f. XXVI, 9 Le Bes Wadington, «*Voyage...*», nr. 1111, f. 26.

## PUSHTIMI OSMAN DHE SHKATËRRIMI BARBAR I MONUMENTEVE TË LASHTËSISË

Pas vdekjes së Skënderbeut bie në dorë të push-tuesve osmanë edhe qyteti i Shkodrës (1479). Luftë-rave shqiptaro-turke për mbrojtjen e këtij qyteti i thuri himn Barleti, dëshmitar okular i këtyre ngjar-jeve të përgjakshme në veprën e vet «Rrethimi i Shkodrës». Këtij i përket edhe një vepër madhore, «Historia e Skënderbeut», vepër që ka pushtuar she-kujt, himn i vërtetë patriotizmi dhe atdhedashurie. Pe-na e fuqishme e Barletit me tablo mahnitëse të jep përpjestimet gjigante të luftës dhe heroizmin e vër-tetë të shqiptarëve për mbrojtjen e trojeve të veta. Edhe një humanist tjetër, Marin Beçikemi, e ngre me forcë zërin e vet duke na përshkruar tablo rrëqethëse, tregon për trimëritë e pashoqe të bashkatdhetarëve. Ndërsa piktori i madh i Rilindjes Evropiane Paolo Kaliari i quajtur «Veroneze», kompozoi dy tablo: një-  
ra paraqet rrethimin e Shkodrës, tjetra — mbrojtjen e Shkodrës, të dyja të mrekullueshme. Me dorën e vet ai shkroi këto fjalë: «Shkodra e sulmuar me të gjitha mjetet e luftës prej turqve, për një kohë



të gjatë dhe me fuqi i bëri ballë duke qendruar rreptë».

Pas saj u pushtuan edhe qytetet e tjera të Shqipërisë, Durrësi (1501), Ulqini (1571) dhe më parë kishin rënë kështjella famëmadhe e Krujës (1478) dhe ajo e e Lezhës (po më 1478).

Duke mos duruar zgjedhën e të huajit mbi dyqind mijë shqiptarë (një masë e madhe populllore) kapërcyen detin dhe u vendosën në Kalabri e Sicili. Të tjerë u vendosën në Venedik dhe Padovë, ku midis tyre do të bënin emër talente të fuqishme të Rilindjes Evropiane. Marin Barleti do të përkthehej në të gjitha gjuhët e Evropës. Marin Beçikemi për dhjetë vjet me radhë drejtoi shkollën e lartë të Raguzës dhe u dërgua me misione diplomatike nga Republika e Venedikut në oborret e Napolit dhe të Firences. Leonik dhe Bartolome Tomeu nga Durrësi ishin personalitete të larta të kulturës, poetë, filozofë, shkencëtarë të shquar dhe përkthyes në zë të Aristotelit dhe të filozofëve të tjerë të lashtësisë.

Turqit osmanë qytetet e lulëzuara të Shqipërisë (ku kishte nisur të merrte hov mendimi i përparuar i Rilindjes Evropiane) i kthyen në qendra dhe garnizone ushtarake. Qyteti i Shkodrës u shkatërrua. Ishin shkatërruar edhe Kruja dhe Lezha, ndërsa qyteti i Durrësit (në kronikat osmane quhej «një Konstantinopol i dytë») nga njëzet e pesë mijë banorë që kishte në mesin e shekullit të 14-të, duke u radhitur ndër qytetet më të mëdhenj të Evropës e ku dalloheshin zejtarë, gu-rëgdhendës, metalurgë, mjeshtër të punimit të arit, argjendit, hekurit, plumbit, bronzit, kallait dhe një numër i madh piktorësh dhe muzikantësh, ky qytet kishte në këta vjet teatrin e vet të marionetave, një kor të madh, aty kishte dalë gjithashtu një nga muzikantët më të mëdhenj të Bizantit, Jan Kukuzeli, arriti të ketë vetëm dy mijë banorë. Kalaja madhështore me tri radhë mure



1. Durrësi, viti 1571, sipas një gravure të atlasit të Kamocios (Camozius)

rrethuese u reduktua në një katërkëndësh të thjeshtë me një perimetër fare të vogël. Për ndërtimin e këtyre mureve turqve osmanë u shërbyen si lëndë e parë monumentet e shumta antike të qytetit. Edhe sot një sy i kujdesshëm do të dallojë mjaft fragmente arkitektonike, kolonash, kapitelesh dhe mbishkrimesh të murosuras, fragmente të një ore diellore, të një stele të Hermesit; të një pllake të gdhendur me lule, të një frizi dhe stele të një luftëtari. (Megjithëse gjatë shekujve janë hequr nga arkeologë dhe grabitës profesionistë me dhjetëra objekte të tjera me vlerë, që sot gjenden nëpër muze të huaja).

Po ndodhte si në baladën e lashtë, por këtu në



themelet e ndërtimeve të reja bëheshin fli monumentet e vjetra<sup>1)</sup>.

Evropa në këta vjet jetonte lulëzimin e saj kulturor me Rilindjen Evropiane. Monumentet e antikitetit mbroheshin, shtatoret prej mermeri, mbishkrimet e lashta mbledheshin dhe studioheshin me kujdes. U krijuan kështu qendrat e para muzeale. Arti i antikitetit jetonte ripërtëritjen e tij. Por ndryshe ndodhte në Shqipëri. Pushtuesi i egër osman (në fjalorin e Frang Bardhit ka një proverb të tillë: «Ku shkel turku nuk mbin bar» ringjalli Mesjetën.

Ripërsëritej ajo që ishte bërë shekuj më parë nga luftërat e vazhdueshme në këtë «Portë të lindjes dhe të perëndimit», nga fatkeqësitë e natyrës dhe të obskuranizmit fetar.

Me vendosjen zyrtare të krishtërimit në shekullin e 5-të të epokës sonë, teatrot dhe amfiteatrot u ndaluan me ligj. (Teodosi II në vitin 435 urdhëroi të shkatërroheshin gjithë tempujt paganë). Ato u prishën për t'i përdorur si gurore për ndërtime të tjera. Ky duhet të ketë qenë fati i Odeonit dhe i Teatrit të Apolonisë aq shumë të shkatërruar, atij të Durrësit, Butrintit dhe Bylisit.

---

1) Udhëtarë të shumë flasin për këto monumente të murosurat: A. Degrand, «*Souvenirs de la Haute Albanie*», Paris 1901, f. 179-183:

«Luftërat e vazhdueshme për të pushtuar këtë portë të lindjes (Durrësin, H. U.) kanë shkatërruar tempujt dhe ndërtesat e bukura... ajo çka mbeti është përdorur vazhdimisht nga vendësit dhe turqit për të ndërtuar fortifikimet e më vonë shtëpitë. Çfarë fragmentesh interesante skulpturash mermeri të stileve dhe epokave të ndryshme mund edhe sot të shihen duke kaluar nëpër muret e kësaj kalaje të lashtë. Nëpër rrugë, nëpër muret e shtëpive dhe gjithkund mund të shikosh provat e begatisë dhe shkallës së civilizimit artistik të qytetit».

Justin Godard, «*L'Albanie en 1921*»:

«Mbërritja në Shqipëri bëhet në Durrës. Ky është një qytet shumë i vjetër, e kaluara e shkëlqyer e të cilit duket në çdo anë. Mbeturina të kolonave dhe mbishkrime gjenden akoma nëpër mure.»



Amfiteatri i Durrësit u kthye në varrezë dhe në një nga kamaret e tij u ndërtua një kapele e vogël bizantine.

Në këtë periudhë vihet re një intensitet i jashtëzakonshëm për të ndërtuar tempujt dhe godinat e reja me material të tempujve dhe godinave të lashta. Në muret rrethuese të qytetit të Bylisit, të ndërtuara në periudhën e perandorit Justinian, janë futur një numër i madh kolonash, pjesësh arkitektonike e skulpturash dhe pjesë nga ndenjësjet e gurta të teatrit. Në kalanë e Bashtovës gjithashtu do të gjesh nëpër muret e saj pjesë arkitektonike të ndërtimeve të lashta.

Shkatërrimtare kanë qenë luftërat ikonoklaste (shekulli VIII), të cilat zhdukën monumentet dhe veprat e artit, sidomos ato të karakterit pagan. Shqipëria që i jetoi intensivisht këto luftëra u dëmtua rëndë.

Por ajo që ishte bërë më parë nga fiset barbare, nga pushtuesit bullgarë, normanë, venecianë, po ripërsëritej e dhjetëfishuar nga pushtuesit osmanë. Ripërsëritej tragjedia e shekujve të shkuar për kulturën e antikitetit. Mermeri i bardhë i shtatoreve antike shërbeu si lëndë e parë për furrat e gëlqeres, që funksionuan për një kohë shumë të gjatë. Ende në vitin 1900 në Apoloni edhe në Durrës kishte një tog furrash ku digjeshin monumentet<sup>1)</sup>. Në një nga galeritë e amfiteatrit të Durrësit shihen ende gjurmë të gëlqeres së djegur. Ndërsa Statuja e Kalorësit, për të cilën kishin shkruar Ana Komnena, Pakimer Barleti dhe Dalmato dhe që e kishte parë vetë Kiriaku i Ankonës, ndoshta u shkri nga fonderitë lëvizëse që i merрте me vete ushtria e sulltanit, pas pushtimit të qyteteve,

---

1) Karl Paç, «Gjendja ekonomike...», f. 36:

«Në vitin 1900 ishte afër manastirit të Pojanit një gropë gëlqereje, ku digjeshin monumentet».

Hasan Ceka. «Apolonia», Tiranë 1958, f. 15:

«Ende në vitin 1900 vepronin në Apoloni një tog furrash gëlqereje, që ushqeheshin e digjnin skulptura e mbishkrime antike të skalitura mbi gur gëlqeror ose mermer».

për të derdhur topat e rinj, që do të fortifikonin kësh-tjellën. Të njëjtin fat kanë pasur edhe shumë monu-mente të tjera prej bronzi në qytetet e tjera shqip-tare të pushtuara nga turqit si në Shkodër, Lezhë, Krujë.

Janë po pushtuesit osmanë që në këto qytete zhdukën mjaft dokumente të vjetra me vlerë dhe libra të shkruara në gjuhën shqipe. S'është i rastit ankimi që bën Mark Skura, kryepeshkop i qytetit të Durrë-sit dhe luftëtar, për librat me shumë vlerë që «do-gjën të pabesët (është fjala për pushtuesit osmanë, H. U.) në katedralen e qytetit,» kur pushtuan Krujën.<sup>1)</sup>

Statuja dhe fytyra të shumta u gjymtuan sepse, sipas konceptit fetar islamik, ishte përdhosje të rifi-gurohej njeriu. Tempujt e vjetër të mbushur me afreske dhe mozaikë u modifikuan në objekte kulti të fesë islame, duke shkatërruar vlerat e tyre të mëdha his-torike dhe artistike.

Ibrahim pasha i Beratit tërhoqi nga një monu-ment mortor në formë tempulli më se shtatëdhjetë qerre me gurë të skalitur, të cilat i përdori për ndër-timin e sarajeve të veta. Teqja e helvetive në Berat është ndërtuar pikërisht nga ky material gurësh, që u morën nga ky tempull i permendur.<sup>2)</sup> Në disa raste shkatërrimi ka qenë tepër barbar sa nga një tempull i Shtyllasit, ngritur në një kodër të butë në jug të Apolonisë, ka mbetur në këmbë vetëm një kolonë.<sup>3)</sup>

1) «Historia e letërsisë shqipe», botim i USHT, vëll. 1, 1959, f. 181.

2) Karl Paç. «Gjendja ekonomike...», f. 34:

«Një faltore ishte në juglindje të Pojanit, afër kaso-lleve të mjerueme të katundit Kryegjatë; pjesën më të madhe të tepricave të kësaj faltoreje e mori Ibrahim pasha, i cili transportoi 70 qerre me gur, për të ndërtuar pallatin e vet në Berat.»

3) Tempulli ka pasur këto përmasa: 40 m gjatësi, 23 m gjerësi, rreth e përqark kishte 34 shtylla me 6.62 m lartësi dhe 1.36 m diametri, d.m.th. 1 m më të larta se ato të tempu-llit të permendur të Tezeut në Athinë dhe me diametër 0,36 m më të mëdha.



Körkund s' shihej asnjë përkuajdesje për mbrojtjen e tempujve të së kaluarës. Në shtëpinë e Vrionasve në Fier ishin murosur statuja dhe shtylla të vjetra.<sup>1)</sup> Kishat që nga Semani në Vjosë e tutje gjer në Vlorë dhe Berat nëpër muret e tyre mbanin fytyra prej mermeri të perëndive pagane.

«Edhe pse me qindra e qindra përkuajtimore të rëndësishme në pikëpamje të historisë, të kulturës u transportuan për ndërtime kishash ndërmjet Vjosës dhe Semanit e më tutje në Berat dhe Vlorë, edhe pse shumë skulptura u çuan jashtë vendit... prapëseprapë toka e Pojanit është shumë e pasur me monumente, aq e pasur sa kurrë një vend tjetër në krejt Evropën».<sup>2)</sup>

Kolona të larta dhe kapitete të të gjitha stileve hidheshin në breg të detit, për ta mbrojtur bregun nga vrulli i dallgëve.<sup>3)</sup> Para dyerve të shtëpive shihje shtylla të ngulura sido në dhe, për t'u hipur kuajve.

Kudo që t'i hidhte sytë, udhëtari do të ndeshje me copëza të masakruara nga lashtësia. Megjithatë shumë mure të kalasë së Durrësit dhe të Manastirit të Pojanit padashur ishin kthyer në miniera antikitetesh ose në muze të hapura në natyrë.

«Ky mur (i qytetit të Durrësit, H. U.) me një pìrg katërkëndësh mbi Porten Grande me copa mermeri, me skulpturë (gdhenarim) të vjetër, me mbishkrime... me gurë varresh dhe stema, duket si një muze i vërtetë».<sup>4)</sup>

1) «Posta e Shqipnis», 11 shtatuer 1918, nr. 77:


«Kah pazari shihet shtëpia e Vrionasve... e syri ndeshet gjithkund ndër statue e shtylla, marrë e pru aty prej rrëimeve të Apolonisë së vjetër.»

2) Karl Paç. «Gjendja ekonomike...», f. 35-36.

3) Po aty, f. 29:

«Pasuria e mermerit çmohet aq pak në Durrës saqë shtylla shumë të çmueshme, të cilat gjetiu kishin për t'u ruajtur me kujdes të madh dhe për t'u përdorur për qëllime zbukurimi hidhen në det për të mbrojtur bregun nga tallazet.»

4) Dr. Milan Shuflaj. «Serbët dhe shqiptarët», Tiranë 1926, f. 14.



2. Ujësllësi i Gjirokastrës, sipas një gravure të piktorit anglez Eduard Lir (Edward Lear), viti 1848.

*«Manastiri i Pojanit dukej si një muze i rregulluar: andej-këndeje shiheshin nëpër mure të tij relieve; ndër skajet e oborrit gjindeshin shtatore, altare, copa shtyllash e kapitule, kapakë sarkofagesh të lashtë...»<sup>1)</sup>.*

Ky shkatërrim vazhdoi me ritme të mëdha edhe gjatë periudhës së regjimit antipopullor të Zogut. Në Gjirokastrë u prish ujësllësi i vjetër, të cilin e pat pikaturuar në vitin 1848 Eduard Liri.

Në Durrës u hodh në erë Bastioni në breg të detit dhe u shkatërrua Porta e Madhe. Patrioti Loni Logori, duke mos duruar këtë gjendje, hartoi një epigramë të mprehtë, ku vinte në lojë qeverinë dhe inxhinier Skanjetin, drejtues të këtyre prishjeve, duke theksuar se ky ishte

---

1) Karl Paç. «Gjendja ekonomike...», f. 37:

dëmi më i madh nga gjithë dëmet që kishin shkaktuar tërmetet shkatërrimtare të Durrësit.<sup>1)</sup> Ndërsa në gazetën «Shekulli i ri» (6 nëntor 1928) jepet lajmi se një ditë më parë kishte filluar «rrëzimi i Portës së Madhe», për të ndërtuar bulevardin modern të qytetit.

Leon Rej, duke mos kursyer ironinë, shkruante në ato vite:


*«Megjithëse Bastioni i Madh që mbronte limanin e Durrësit u rrënuar tani së fundi, prapë ajo që mbetet nga muret e lashtë i jep qytetit një pamje piktoreske. Është për të uruar që kësaj shkatërruese i kurseu këto gjurmë, studimi i të cilave ka interes jo vetëm për historinë e Durrësit, por edhe për atë të fortifikatave në përgjithësi.»<sup>2)</sup>*

---

Kjo plotësohet dhe nga thëniet e Leon Hëzejt «Manastiri i Pojanit është mjaft i njohur si një minierë antikitetesh të bukura «Mission Archeologique de Macedoine». Paris 1876, f. 395; të Kostantin Jireçekut «Kuvendi (është fjala për Manastirin e Pojanit, H. U.) duket si një muze plot me shtatna, skulptura dhe gurë të shkruar», Revista «Agimi», tetor 1920, nr. 6, f. 88. «Vlona në kohë të mesme».

1) «Kalendari Kombiar», 1928, f. 88, Epigramë: «Tërmetet në Durrës dhe plani i ri i qytetit». «Me vendim të qeverisë/ I jepet urdhër perëndisë:/ Të pushojë tërmetin! Se për të rrëzuar/ Dhe për të shkatërruar/ kemi emëruar inxhinier Skanjetin.»

2) «Albania», Revue d'archeologie, d'histoire, d'art et des sciences appliquées en Albanie et dans les Balkans, viti MCMXXV, nr. 1, f. 33-48.



3. Bastioni i madh në breg të detit i Kalasë së Durrësit, i shka





tërruar për të ndërtuar ndërtesën e Bankës.



## GRABITJA E MUZEVE NË NATYRË

### Leon Hëzej një arkeolog grabitës

Nga mesi i shekullit të nëntëmbëdhjetë, udhëtarë dhe përfaqësues konsullorë të huaj erdhën në Shqipëri dhe treguan një interesim të madh për objektet e ndryshme arkeologjike, këto thesare të braktisura, që i shikonin lirisht nëpër muret e kalave, ndërtesave dhe kishave, kudo që shkonin. Këto muze në natyrë, të pambrojtura, filluan të grabiten. Nga Manastiri i Pojanit hiqet një Tors i Bakut fëmijë nga Goltier de Klabri, anëtar i shkollës franceze në Athinë e dërgohet në Luvër.<sup>1)</sup>

Më parë ishte grabitur nga Butrinti edhe një mbi-

---

1) Leon Heuzey, H. Daumet, «Mission Archeologique de Macedoine», Paris 1876, f. 395:

Manastiri i Pojanit «ka furnizuar Luvrin me një Tors të Bakut fëmijë... i dhuruar nga M. Goltier de Klabri».

Karl Patsch, «*Scriften der Balkan Kommission Antiquarische Abteilung*», Wien 1904, f. 154:

«Një tors te Praksitelit të një satiri e ka dërguar në Luvër nga Apolonia Goltier de Klabri më 1859. Ai qendron në sallën e Tibre nr. 665».

Leon Rey, «*Albania*», 1. f. 11, shënim 9:

«Muzeu i Luvrit posedon disa skulptura të marra nga Apolonia përkatësisht nga M. Goltier de Klabri, Grasé, konsull i Francës në Korfuz, dhe Leon Hëzej.»

shkrim që e kishte kopjuar Kiriaku i Ankonës dhe që dërguar në muzeun «Naniani» të Venedikut.<sup>1)</sup> Më pas Andre Grase, konsull i Francës në Korfuz, heq përsëri nga Manastiri i Pojanit një statujë të Vitories, që mbante në dorë trofenë.<sup>2)</sup>

Këto janë thërrimet e para të dokumentuara që herët të grabitjeve arkeologjike të vendit tonë. Më pas do të vijë në Shqipëri Leon Hëzej, profesor i historisë dhe i arkeologjisë në Akademinë e Arteve të Bukura dhe anëtar i Muzeut të Luvrit dhe H. Domë anëtar korrespondent i Akademisë Franceze në Romë, arkitekt i shtetit, të dërguar të posaçëm të Napoleonit III për të studiuar në vend luftën civile në mes të Cezarit dhe Pompeit.

Hëzej ishte një arkeolog specialist dhe diti ç'të marrë e ç'të dërgojë në Luvër; ai grabiti thesare të vërteta kulturore dhe artistike me vlera të mëdha.

Hëzej dhe Domë zbritën në Palasë të Himarës prej anijes «*La Bische*» po në atë vend ku kishin zbarkuar edhe ushtritë e Cezarit. Prej andej shkojnë në Orikum e Durrës dhe më pas në Apoloni, ku bëjnë një ekskursion të shkurtër dhe tepër fitimprurës.

Në Apoloni habiten me gërmadhat e shumta që shohin përreth. Vërtet që Apolonia ishte një minierë e madhe antikash, një muze i hapur, ku thesaret ishin të lëna pasdore mbi sipërfaqe të tokës. Ata shtrijnë duart dhe mbledhin prej tyre ato më të bukurat dhe më me vlerë. Donin t'i transportonin për në Vlorë, por këtu hasej vështirësia. Objektet ishin të rënda

---

1) Le Bas Wadington, «*Voyage Archeologique...*», 1865, vol. 1, f. 256, nr. 1092:

«Ky mbishkrim i Butrintit i kopjuar prej Kiriakut të Ankonës është transportuar në Venedik në muzeun «Naniani» dhe i atribuohet shekullit të dytë para erës sonë».

2) Leon Heuzey, H. Daumet, «*Mission archeologique...*», f. 395:

«Manastiri i Pojanit ka furnizuar Luvrin me një statujë të Vitories që mban në dorë trofenë dhe është dhuruar nga A. Grase, konsull i Francës në Korfuz.»



dhe mjetet e komunikacionit ishin të pakta. Një pengesë serioze ishte që të binin në marrëveshje me autoritetet turke dhe këtë e sigurojnë me anë të ryshfeteve, megjithëse kohën e qëndrimit e kanë fare të paktë.

*«Koha e paktë që ne i kishim lënë topografisë historike na u mor sepse na u desh të studionim mbi-shkrimet dhe fragmentet e shumta, që formonin rreth nesh një muze të vërtetë... Gjithashtu e humbëm kohën nëpër bisedimet që të arrinim t'i transportonim për në Vlorë ato objekte që na dukeshin se e meritonin të dërgoheshin në Francë<sup>1)</sup>».*

Hëzej dhe Domë shkuan edhe më tej Apolonisë, në Shtyllas, dhe Domë ndjek nga afër planimetrinë e këtij tempulli të madh. Pastaj kthehen përsëri në Apoloni dhe arrijnë t'i transportojnë për në Vlorë disa skulptura me vlera të veçanta.

Hëzej tregon nëpër faqet e librit për një kokë femre që i kishte rënë menjëherë në sy për paraqitjen e saj të veçantë dhe mendon për t'i dhënë asaj një vend të nderuar në Muzeun e madh të Luvrit. Kohë më parë ky muzeum ishte pasuruar me objektet egjiptiane prej Napoleonit I gjatë fushatës së tij në këtë vend, i cili kishte marrë me vete një turmë shkencëtarësh dhe historianësh, e që po pasurohej përsëri nga Napoleoni III, që, siç thotë Marksi, ishte një kopje komike e të parit, i cili tashmë kishte dërguar në territorin e Ilirisë së Lashtë me një dekret të posaçëm Hëzejn dhe Domënë.

Hëzej shprehet kështu për këtë kokë të bukur prej mermeri:

*«Di të them që unë s'kam parë një kokë antike që t'i afrohet aq shumë ëmbëlsisë dhe trishtimit që artistët... kanë realizuar më vonë në figurat e madonave. Përkulja e kokës nga krahu që e mbulon pjesërisht*

---

1) Leon Heuzey, H. Daumet, «Mission archeologique...», f. 395-396.



4. Kokë femre nga Apolonia (Luvër).

*ia shton edhe më shumë intensitetin e shprehjes së veçantë.»<sup>1)</sup>*

1) Leon Heuzey, H. Daumet, «Mission archeologique...», f. 396.

Kuptohet që kjo kokë ishte një kryevepër e artit antik e punuar nga skulptorët vendës të Apolonisë. Është pranuar nga të gjithë studiuesit që në Apoloni arti, veçanërisht ai i skulpturës, kishte arritur të krijonte një shkollë, që nuk kopjonte me besnikëri veprat e mjeshtërve të dëgjuar të botës greke, por ndiqte shpesh një rrugë të vetën dhe krijonte vepra origjinale. Këto vepra bien në sy veçanërisht për origjinalitetin e kompozimit të tyre, për harmoninë e ndërtimit dhe për pasurinë, zgjedhjen dhe rresh-timin e zbukurimeve. Mbi të gjithë dallojnë gurët mortorë dhe kapitelet që me mermerin e tyre të bardhë duken sikur shpërthejnë lule. Këto monumente nuk i hasim me këtë bukuri në asnjë vend tjetër të botës antike.

«Duke shëtitur kolonat profesori (është fjala për arkeologun francez, Leon Rejn), na drejtoi te një shtyllë me një stil krejt të ri. Këtë formë kaq të bukur nuk mund ta shijojë vizitori as në Delf, as në ndonjë vend tjetër të Greqisë. Këtë do ta emërojmë arti apoloniat, tha. S'ka aspak të përngjarë me stile të tjera. Mbi kokën e shtyllës ishin gdhendur dy lule me bisht të bashkuar dhe në mes një lule e tretë. Ishte një punim i rrallë... Një portë e çuditshme kjo, tha (kur shkuan te porta e akropolit, H. U.) Kulmi i saj formohet prej bashkimit të dy harqeve që kanë një përkulje gradësh në sasi të njëllotë. Dalngadalë do të pasurohemi me një art të ri. Vizitori që do të shtegtojë në Delf ka arsye që të kthehet edhe në Pojan pse do të shijojë një art që s'ndodhet në asnjë vend tjetër të Ballkanit... Pastaj na tha: «Kjo është pasuria e vendit tuaj të bekuar.»<sup>1)</sup>

Po në këtë periudhë në Apoloni vepronte një

---

1) «Drita», 25.8.1938, «Ç'na tha profesori Leon Rejn» — ..Apolonia si qendër artistike.

H. Ceka, «Apolonia», Tiranë 1958. f. 11, flet gjithashtu për artin e veçantë apoloniat.



shkollë për oratori dhe filozofi, që gëzonte një autoritet të padiskutueshëm. Nuk është e rastit që Oktavian Augusti i vazhdoi studimet e veta në Apoloni, e bashkë me të një nga ushtarakët më të zot të Romës perandorake, Agripa, fituesi i betejës së Aktiumit në vitin 31 para epokës sonë. (Është me mjaft interes të theksohet se flotën e tij ai e kishte ndërtuar në bazë të liburnideve ilire, këtyre anijeve të shpejta dhe tepër të manovrueshme në det të hapur, që i përdori me sukses të madh kundër anijeve të rënda greke që bënë pjesë në flotën e Antonit dhe të Kleopatërës).

Oratori dhe filozofi i përmendur Ciceron, që e vizitoi këtë qytet në mesin e shekullit të parë të erës sonë, megjithëse vinte nga një qytet i madh siç ishte Roma, mbeti i habitur kur shkeli bregdetin ilir dhe para syve të tij u shfaq panorama me kodrat e buta, ku gjarpëronte lumi i Vjosës, të mbushura plot e përplot me godina dhe monumente madhështore. Në shkrimet e veta ai s'do të kursejë lëvdatat dhe do të shprehet për të me fjalët që kanë kapërcyer shekujt: «Magna urbis et gravis» (Qytet i madh dhe hijerëndë.)<sup>1)</sup>

Apolonia kishte edhe filozofët e vet. Në një gur varri të gjetur në Apoloni marrim vesh për një filozof të shkollës pitagorike. Qyteti kishte gjithashtu dhe aktorët që luanin në skenat e Odeonit dhe të teatrit të madh komeditë dhe tragjeditë klasike. Kishte dhe muzikantë të dëgjuar. Zbulimet arkeologjike të mëvonshme kanë nxjerrë mjaft figurina prej bronzi dhe në baltë të pjekur, që paraqesin muzikantë që i bien fyellit, sirinksit, apo hedhin valle të ndryshme.

Hëzej dhe Domë shihnin para syve një Apoloni të shkatërruar dhe me një fat tepër tragjik. Gërmadhat mbushnin kodrat, rrugët e qytetit i kishte mbuluar bari, ndërsa muret antike ishin tepër të rrënuara. Pak më vonë aty do të vinte dhe një arkeolog tjetër, A. Zhileron, i cili ndonëse me gabime do të përpiqonte planimetrinë e këtyre mureve, që do të ribotohej

1) H. Ceka, «Apolonia...», 1. 11.

dhe në librin e Hëzejt mbi luftën civile të Cezarit dhe të Pompeit.<sup>1)</sup>

Hëzej dhe Domë ngulën dhe një kazmë tjetër në atë që kishin bërë shekujt, grabitën. Ata tregojnë se kishin marrë nga Apolonia dhe kishin dërguar në Luvër dhe tre kapitete të vegjël prej mermeri të bardhë të punuar me mjeshtëri, një antifeks tempulli dhe një maskë luani, një friz me figura të vogla që paraqiste një luftë amazonash.<sup>2)</sup>

Në katalogun e monumenteve të shpëna në Luvër, Hëzej tregon se ka dërguar atje dhe një stele të një kalorësi apoloniat.<sup>3)</sup>

Në Durrës Hëzej dhe Domë qëndrojnë për një kohë më të gjatë. Edhe ky qytet ashtu si Apolonia ishte një qytet i madh dhe i lulëzuar i antikitetit. Tukididi për të kishte shkruar se Dyrrahi ishte i fuqishëm dhe me banorë shumë. Ciceroni e kishte quajtur «qytet të admirueshëm (admirabilis urbs) dhe me popullsi të madhe», Katuli – «tavernë të Adriatikut», ku sundonte hyjnesha Venus, Lukani ishte shprehur se atë që e forconte këtë vend, Durrësin, natyrën dhe pozicionin e tij, asnjë hekur nuk mund ta shkatërronte, ndërsa Prokopi i Gazës kishte shkruar gjithë entuziazëm: «Epidamnit i këndojnë shkrimtarët dhe bashkë me ta buçet fama për të si një qytet që zgjatet nga toka në det... Dhe kur ndonjëri duke lundruar

---

1) A. Gileron, «Etude sur les ruines d'Apollonie», në «Monumenta Grecs publies par l'Association pour l'encouragement des etudes grecques en France», 1877, nr. 6, f. 11, fig. 13.

L. Heuzey, «Les Operations Militaires de Jules Cesar», Paris 1866, f. 30, tabela III.

2) Leon Heuzey, H. Daumet, «Mission Archeologique...», f. 393.

3) Në katalogun e monumenteve të shpëna në Luvër nga Apolonia, Hëzej vë këto objekte: Kokë e Demetrës me velo, mermer; antifeks, kërcimtare me palmetë, mermer; kapitel i vogël jonik, mermer; kapitel i vogël, dorik, stele e kalorësi apoloniat, gur.



del nga deti Jon (në lashtësi Joni dhe Adriatiku identifikoheshin), ai ulet përpara anijes dhe kthehet nga qyteti duke u ushqyer me kënaqësi me pamjen e sendeve që shikon». Për të kishin shkruajtur Herodoti, Plutarku, Apiani, Aristoteli, Eratosteni, Straboni, ndërsa Plauti kishte ndërtuar një komedi ku aksioni zhvillohej në Durrës. Aty ishte bërë dhe lufta famëmadhe në mes të Cezarit dhe të Pompeit, që kishin ardhur për ta studiuar pas kaq shekujsh Hëzei dhe Domë.

Ai, Cezari, kishte ardhur gjer pranë mureve të fortifikuara të qytetit, në tempullin e Artemisit. Qyteti kishte shumë ndërtesa dhe tempuj madhështorë, atë të Minervës, të Venerës, bibliotekën, amfiteatrin, termat, shtëpitë e zbukuruara me afreske dhe mozaikë. Po Hëzej dhe Domë, ashtu si në Apoloni, shikonin vetëm gërmadha, rrënimë të lashta, fragmente të copëzuara të asaj bukurie që kishte parë vetë Cezari.

Në muret e kështjellës së Dyrrahut ata shohin dhe përshkruajnë mjaft monumente të lashta, një mbishkrim që e kishte kopjuar Kiriaku i Ankonës, një basoreliev arkaik, një fragment stele, një maskë të Gorgonës, një portret gruaje, të gjitha prej mermeri të bardhë, një basoreliev të një vitoreje, që vinte nga një hark triumfi, flasin për tre mbishkrime në brendi të rrënojave, që bënin fjalë për priftërinj të Mitrës, për mjekun okulist Filolog dhe të duumvirit Telus, që kishte kontribuar për ndërtimin e bibliotekës së qytetit, për stemat njëra e Anton Kopelitet, që mbante datën MCCCCXLVII, dhe tjetra shumë e rëndësishme, që kishte të gdhendur një zog krahëhapur, i cili duket si një shqiponjë dhe dy mburoja me gdhendje tepër të thjeshtë.

Domë bën disa riprodhime të këtyre objekteve dhe një vizatim të qytetit, i parë nga plazhi i sotëm. Qyteti ka shtrirje gjatore. Në det duket një anije, spikat vija e limanit dhe menjëherë ngrihet figura katërkëndëshe e Bastionit të Madh, ku ka qenë porta e Jallisë (e detit), duken muret e vjetra të kështjellës bizantine (shekulli 5-6) kurse në qendër dhe në



5. Alto-reliev nga Durrësi  
(Luvër)



6. Alto-reliev nga Durrësi  
(Luvër)

kodër duken muret e kështjellës turke. Ky vizatim të jep një përfytyrim të plotë të shtrirjes së kalasë së qytetit të Durrësit edhe për vetë faktin se Domë, si arkitekt që është, i ka ndenjtur besnik topografisë dhe arkitekturës së kështjellës.

Leon Hëzej merret me përshkrimin e monumenteve të tjera të lashtësisë. Edhe ai, ashtu si më parë Kiriaku i Ankonës, shkon te «Porta» dhe në Arapaj merr për ta dërguar në Luvër mbishkrimin që bënte fjalë për riparimin e ujësjellësit të Durrësit. Hëzej



7. Fragment frizi, kokë kau me kurorë, nga Durrësi (Luvër)

shkon edhe më tej në fshatin Pjeshkëz të Shijakut dhe në Kavajë, ku përshkruan disa mbishkrime.

Në qytetin e Durrësit Hëzej merr edhe disa monumente me vlera të veçanta: një mbishkrim të Sur Epidamnit, një fragment frizi, kokë kau me kurorë dhe dy figura në relief të thellë të Demetrës dhe Kores.<sup>1)</sup>

1) Ndërsa nga objektet që ka dërguar në Luvër nga qyteti i Durrësit, në këtë katalog fjiurojnë: Mbishkrimi i ujësjellësit të Durrësit, mermer; dy figura në altoreliev: Demetra dhe Kore, gur, fragment frizi, kokë kau me kurorë.

Këto dy skulptura u gjetën në jugperëndim të qytetit, së bashku me një skulpturë tjetër shumë të gjymtuar, të ndara në blloqe të mëdha, pjesët anësore të të cilave ishin të prera në mënyrë të rëndomtë dhe kishin gjurmë sharrimi. Mund të ishin vendosur në ndonjë godinë ose tempull të qytetit. Skulpturat janë pa kokë. Demetra ka një erashkë që e mban në dorën e djathtë, një velo valëvitëse dhe dallohet për një qëndrim tepër të gjallë. Kore mban në dorën e majtë një shportë të madhe dhe në dorën e djathtë një lloj rrige ose shtize të thyer në pjesën e sipërme. Ka një qëndrim statik në kontrast me Demetrën. Së bashku me to u gjend edhe mbishkrimi i Sur Epidamit, kalorës, mbrojtës i qytetit duumvir quinquenal të cilit mjeshtrat karpentierë të Dyrrahut i kishin ngritur një monument. Interesi i këtij mbishkrimi qëndron në emrin që mban, Epidamnos, që e shohim të figurojë në mes të emrave të funksionarëve të lartë të qytetit. Ky mbishkrim i lashtë është si një «dokument i gjendjes civile» i gdhendur në gur.

Pastaj për ta bërë më të plotë eksplorimin e tij arkeologjik Hëzej i lutet kapitenit të anijes «La Bische» të bëjë një studim të kujdesshëm të shkëmbinjeve të Currilave, për të parë nëse aty mund të gjendeshin gjurmë të një moli antik, por ai nuk zbuloi asgjë, asnjë shenjë punimi nga dora e njeriut, «megjithëse tradita vendëse (gjithmonë për të zmadhuar së tepërmi punimet e së kaluarës) kishte krijuar një ide madhështore të punimeve që e bënin Dyrrahun e lashtë një fortesë bregdetare të rëndësishme.»<sup>1)</sup> Hëzej këtu gabon sepse zhytësit amatorë të qytetit të Durresit kanë zbuluar në këtë zonë, nën det, gjurmë muresh të vjetra, gjurmë kalldrëmësh e kanë zbuluar me dhjetëra amfora, çka tregon që legjenda e trashëguar e Dyrrahut të përmbytur nga valët e detit është një realitet.

---

1) Leon Heuzey, H. Daumet. *Mission Archeologique...*, f. 376.



Në kopshtin e konsullit austriak, jashtë Portës së Madhe, Hëzej sheh një basoreliev (natyrisht të grabitur më vonë nga ky konsull) që paraqiste dy nimfa të cilave u dalloheshin rrobat e gjata dhe këmbët e mbathura me këpucë. Pranë tyre, deri në lartësinë e palës së rrobave, shtrihet një person me dimensione të vogla, që ngrinte krahët nga mbrojtëset e tij hyjnore, duke u zgjatur një kurorë. Por ajo që e bënte interesant këtë monument, ishte se në anën e kundërt gjënde një mbishkrim i madh me germa të bukura. Është kjo një dëshmi e largët për shkatërrimin e një monumenti shekuj e shekuj më parë, me materialin e të cilit u ndërtua një monument tjetër.<sup>1)</sup>

Hëzej tregon edhe për një mbishkrim në vargje, të gdhendur në një pllakë mermeri, në murin e një kulle katërkëndëshe, sot e shkatërruar krejtësisht, në lagjen Stan të qytetit, të botuar më parë edhe nga Aravantino dhe Hahn e që fragmente të të cilit i kanë rrëmbyer serbët dhe që tashmë ndodhen në Muzeumin Nacional të Beogradit.<sup>2)</sup>

Mbishkrimi i plotë shkruan:

*«Mëso o spektator, cili është ai që e ndërtoi nga fundi në krye këtë kullë, që ti po e sodit, konstrukcion i jashtzakonshëm, admiro përsosmërinë e vizatimeve të saj. Është biri i një njeriu fatlum, i Jan Sebastakorit, lulja e fëmijëve, është Teodori, i shumëmadhi i ekspeditave, bir i fuqishëm i Dukas dhe i Komnenit, si Brireau i pathyeshëm nga armiqtë, i palodhur në punët e tij. Viti në vazhdim përmbliqhte atëherë gjashtë mijë vjet, në pesëqind cikle 7-vjeçare dhe 30-vjeçare dhe një triadë «të thjeshtë» në indikacion (periudhë 15-vjeçare, H. U.) sillte në ecjen e tij të shpejtë, censin sipas erës së krijimit hyjnor.»*

1) Leon Heuzey, H. Daumet, «Mission archeologique...», f. 377.

2) Balduin Sara, «Antiken aus Durazo», në Jahreshefte des Osterreichischen Archeologischen Institutes, Wien, 1926, nr. XXIII, f. 246:

Mbishkrimi tregon për ndërtimin e kësaj kulle në vitin 6733(1225) nga Teodor Engjëll Komneni, despot i Epirit, pasi u kishte marrë venecianëve Durrësin qysh më 1217 dhe ka rëndësi për historinë e ndërtimit të kështjellës së qytetit. Dihet që kjo kala ka qenë fort e madhe dhe tepër e fuqishme. Në shekujt 5-6 ajo u rindërtua me tri radhë muresh me urdhër të perandorit Anastas me origjinë nga qyteti i Durrësit. Tashmë janë gjetur edhe monogramet e tullave, që u prodhuan në atë kohë për rindërtimin e kalasë.

Leon Hëzej nuk bën gërmime arkeologjike, por përshkruan vetëm ato monumente që akoma gjendeshin mbi tokë. Nga ana tjetër, ai është kontradiktor në atë që përshkruan, kjo sidomos kur është fjala për objektet arkeologjike të dërguara në Luvër. Nëpër faqet e librit, ai flet edhe për disa monumente të grabitura, që nuk i ka vendosur në katalogun e përgjithshëm të monumenteve që i ka çuar në Francë, e kjo s'është vetëm një lajthitje, tregon për «singëritetin» e gënjeshtërt të këtij arkeologu, që gjoja e thotë haptazi se ç'ka marrë.

Hëzej dhe Domë erdhën në Shqipëri në vitin 1861. Para tyre kishte ardhur një piktor i shquar anglez Eduard Liri, që kishte bërë pejzazhe lirike me vlera të vërteta artistike për qytetet shqiptare, Shkodrën, Krujën, Tiranën, Durrësin, Beratin, Tepelenën, Vlorën, Himarën dhe Gjirokastrën, që i kishte botuar në ditarin e vet të udhëtimit. Gjithashtu për pasuritë arkeologjike ishin interesuar më parë dhe shumë përfaqësues konsullorë dhe do të interesoheshin edhe të tjerë, që do të vinin më vonë në Shqipëri, që «kohën e lirë» do ta kalonin në studimin (nënkupto grabitjen) e pasurive arkeologjike të Shqipërisë.

## PËRFAQËSUESIT KONSULLORË DHE «PASIONI» I TYRE I ARKEOLOGUT AMATOR

Është një fakt i padiskutueshëm që tregon një realitet të hidhur: mjaft përfaqësues konsullorë, që kanë ardhur në Shqipëri gjatë shekullit të kaluar apo në fillimet e këtij shekulli janë marrë edhe me arkeologji. Ata kanë bërë gërmime pa asnjë lloj kriteri shkencor dhe janë interesuar në mënyrë të ethshme për çdo vlerë arkeologjike të zbuluar rastësisht, për t'ua shitur pastaj muzeumeve të mëdha të Evropës me një fitim të madh.

Para Leon Hëzejt ishin interesuar për objektet arkeologjike të vendit tonë Pukëvil dhe Uliam Martin Lik.<sup>1)</sup> Që të dy ishin të dërguar të posaçëm përkatësisht të Francës dhe të Anglisë tek Ali Pashai.

Pukëvil e vizitoi Apoloninë në vitin 1806. Ai përshkruan me hollësi gërmadhat, flet për një basoreliev antik dhe monedha. Po kështu veproi edhe me Butrintin, Bylisin, duke treguar për ndërtimet pellazgjike dhe gërmadhat e shumta. Pukëvil bën edhe

---

1) F. C. H. L. Pouqueville, «Voyage dans la Grèce», Paris, MDCCCXXI.

W. M. Leake, «Travels in northern Greece», Londër, 1835.

bime në përshkrimet e tij, ngatërron vendndodhjen disa qyteteve të lashtësisë.

Në qytetin e Përmetit, pasi ka takuar një plak që i flet frëngjisht dhe i tregon për udhëtimet e tij në Francë, vizita në kafenenë «Prokop», ku kishte parë Didëronë, Dalamberin dhe letrarët e tjerë të shekullit, ai bën pazar për një medalion antik ku ishte shkruar fjala *Apeirotan*.<sup>1)</sup>

Si Pukëvil, do të veprojë vite më vonë edhe arkeologu austriak Prashniker.<sup>2)</sup> Edhe ai do të bëjë pazare për blerje monumentesh; gjithashtu Degrand, konsull i Francës në Shkodër e shumë të tjerë.<sup>3)</sup>

Krahas grabitjes së drejtpërdrejtë të monumenteve të lashta të vendit tonë është përdorur edhe kjo rrugë tjetër, disi më e «pastër», blerja e objekteve arkeologjike dhe artistike me vlerë nga njerëz matrapazë apo thesarkërkues të ndryshëm, që, të nisur nga fitimet, gërmonin vendndodhjet e lashta, gjurmonin veprat e artit.

---

1) F. C. H. L. Pouqueville, «Voyage dans la Grece...», f. 290-291, vol. 1, *Apolonia*, f. 369-379, 449, vol. 1, *Butrinti*, f. 235, vol. 1, *Bylisi*, f. 316-319, vol. 1 dhe f. 352-382, vol. 2, *Elbasani*; Pukëvil shkruan: «E ndieva veten të lumtur... kur m'u afrua një plak i nderuar, më përshëndeti frëngjisht dhe me një mënyrë fisnike e të sjellë saqë mbeta për një çast pa u përgjigjur. Ai më tregoi për udhëtimet e tij në Paris. Kishte frekuentuar kafenenë «Prokop», ku kishte njohur Didëronë, Dalamberin Frerin dhe letrarët e tjerë të shekullit të fundit. Ai recitonte përmendësh vjershat e Rasinit.

2) C. Prashniker, «Muzakhia und Malakasta», Wien, 1920, f. 46:

«Gjatë kthimit në Tiranë vizitova pazarin e Shijakut dhe vendet e tij në Arapaj dhe Salmonaj... Mbishkrimet ishin zhdukur (është fjala për mbishkrimin e një guri miliar dhe për atë të ujësjellësit të Durrësit, që përmend Hëzej në librin e vet, H. U.). Gjetje të tjera nuk kishte, vetëm disa mone-dha bronzi të kohës së vonë romake, të cilat banorët m'i ofruan t'i blej me një çmim fantastik...»

3) A. Degrand, «Souvenir de la Haute Albanie», Paris, 1901, f. 179-183.



Matrapazë të tillë dhe thesarkërkues të shumtë qarkullonin në këto vite në vendin tonë. Ata vinin nga vende të ndryshme të botës, për të mbledhur objekte artistike dhe historike.

Në vitet 1926-1927 e përshkroi Shqipërinë një matrapaz i huaj, një grek, i specializuar për grabitjen e veprave të artit. Në kishën e Muzinës (Delvinë) ai i vuri syrin një pikturë, kryevepër e artit bizantin në Shqipëri. Në fillim ky matrapaz i premtoi priftit të fshatit 50 napolonë. Por meqenëse ai ishte i pavendosur nga frika e fshatit u premtoi dhe disa fshatarëve me influencë nga 50 napolona të tjerë dhe një vepër, kopje të ngjashme si ajo, për ta zëvendësuar në kishë. Ashtu u bë. Kjo pikturë, kryevepër e artit, përfundoi përtej Atlantikut.<sup>1)</sup>

Po kështu një prift italian (rreth viteve 1916-1917) pasi mori takim me tregtarët e Beratit u lidh me disa fshatarë dhe gërmoi përmbi fshatin Lybesh e pasi bëri disa matje me katër fshatarë, gërmoi për disa ditë rresht e arriti në një kuotë të caktuar. Pastaj u tha fshatarëve që të iknin dhe e vazhdoi vetë gërmimin.<sup>2)</sup>

Grabiti? Ç'grabiti? S'dihet!

Grabitja është dhe kyçi i zberthimit të «pasionit të madh» për arkeologjinë që treguan disa konsuj të huaj.

Është po Pukëvil që në vitin 1819 i ka dorëzuar Bibliotekës Kombëtare të Parisit fjalorin origjinal dygjuhësh greqisht-shqip të trimit suliot Marko Boçarit. Në fletën e parë të këtij fjalori lexohet ky shënim i Pukëvilit: «Ky fjalor është shkruar me dorën e Marko Boçarit, në Korfuz më 1809...»

Uliam Martin Lik përshkruan në Apoloni një tog monumentesh skulpturore dhe mbishkrimesh që mundi t'i shohë në Manastirin e Pojanit, të shpërndara andej-

1) Treguar nga Skulptori i Popullit Odise Paskali.

2) Treguar nga shkrimtari Moisi Zaloshnja.

-këndeje e zë në gojë dhe murin rrethues si dhe ekzistencën në Kryegjatë të gërmadhave të një tempulli të madh. (Është pikërisht ai tempull që shërbeu si lëndë e parë për ndërtimet e sarajeve të Ibrahim pashës së Beratit.)<sup>1)</sup>

Uliam Martin Lik tregon edhe për një relief që paraqet një ndeshje me amazonat. Këtë relief e vizatoi më vonë Domë, ndërsa Prashniker e çoi gjatë Luftës së Parë Botërore në një depo, ku kishte shpënë dhe shumë objekte të tjera për t'i grabitur. Në relief duket një luftëtar, që ka kapur për flokësh një amazonë të përgjunjur, e cila bën çmos që të çlirohet prej tij. Me krahun e djathtë luftëtari mban mburojën, ndërsa nga e majta e tyre nxiton një luftëtar tjetër, me rroben që ia merr era prapa. Ky me dorën e majtë mban mburojën dhe me të djathtën do ta pengojë luftëtarin e parë nga trajtimi i egër që i bën amazonës.<sup>2)</sup>

Me arkeologji u mor edhe konsulli tjetër francez në Shkodër, Hekardi, që mbante titullin e Kalorësit të Legjionit të Nderit. Ai vizitoi krahina të ndryshme të Shqipërisë, qytetet: Lezhë, Durrës etj. dhe përshkroi objekte të ndryshme arkeologjike.

Në Durrës Hekardi flet për monedha të Monunit të gjetura në një varr të hapur në tri metra thellësi. Është e qartë që ai e ka fjalën për ato tipe monedhash, të cilat kanë legjendën *Basileus Monunius*, të prera në kohën kur qyteti ishte nën sundimin e këtij mbreti ilir të taulantëve.

Hekardi tregon për një varr monumental me kolonë dhe një mbishkrim greqisht gjysmë ore larg nga qyteti i Durrësit, ku ishte varrosur një centurion romak i vranë në bëtëjë. Ai kopjon mbishkrimin e

---

1) W. M. Leake, «Travels...» f. 368, vol. 1.

2) W. M. Leake, «Travels...» f. 370, vol. 1.

Lik përshkruan edhe një fragment të një gazele me brirë të drejtë që e ndjek një qen, idem. f. 370.

Sulpicianit, që e gjen në Portën e detit, flet edhe për disa mbishkrime varresh të ndryshme, ku përmendet edhe emri i Euridikës, tregon për qytetin që s'i kalonte të dyqind shtëpitë nëpër muret e të cilave, ashtu si në kalanë e ndërtuar dhe të rindërtuar gjatë shekujve, ruheshin vlera të vërteta arkeologjike.<sup>1)</sup>

As Hekardi, as Uliam Martin Liku nuk kanë marrë objekte arkeologjike nga Shqipëria. Por të tjerët kanë vepruar ndryshe; fare në heshtje, prej Shqipërisë në vende të ndryshme të botës, janë transportuar me qindra e qindra objekte me vlerë historike dhe artistike. Historiani dalmatin Gelciç shkruan:

*«Shqiptari i stolisur me një kuptim të gjerë ndaj të bukurës ka pasë zbuluar qytetet e veta me shtatore dhe objekte artistike fort të çmueshme. Si më parë, ashtu edhe më vonë dhe derisa ranë këto qytete rrafsh për tokë prej zjarrit dhe hekurit të armikut, kanë dalë gjithkund nëpër Ballkan dhe në vise andej e këndeje detit, sende argjendi, fildishi, sadefi si edhe gdhendje armë, enë... të punuara me mjeshtëri e finesë të madhe prej mjeshtrove shqiptarë.»<sup>2)</sup>*

Diletant i arkeologjisë ishte dhe konsulli tjetër i Francës Degran. Në vitin 1899 ai hapi disa varre në varrezën e Kalasë së Dalmaces dhe grabiti vlera të rëndësishme arkeologjike, që kanë të bëjnë direkt me një pikë kyçe të historisë sonë: vazhdimësinë iliro-shqiptarë.<sup>3)</sup>

---

1) Hyacinthe Hacquard, «Histoire et Description de la haute Albanie ou Guegarie», Paris 1858, f. 258-263.

Hekardi shkruan: «Durrësi nuk është më shumë se një qytet i vogël. Gjatë konstruksioneve të mureve ka shumë monumente. Të gjitha janë të shkëlqyera, të marra prej tempujve të zbuluar me statuja, të cilët nuk janë më; tërmetet në fillim dhe më vonë pushtimi turk kanë shkatërruar gjithçka. Gjatë mureve... janë disa mbishkrime që unë i kam kopjuar: janë gjetur në fshatra dhe periferi... statuja dhe gurë varresh.»

2) Josef Gelcich, «La Zeda dela Dinastia dei Balsidi», Split 1899, f. 16.

3) Për këtë meritë të veçantë kanë arkeologët shqiptarë H. Ceka, S. Anamali, F. Prendi, S. Islami etj.

Rrënojat e kësaj kalaje i pati vërejtur Hahn me rastin e udhëtimit të tij në lumin Drin.<sup>1)</sup> Edhe ky kon-sull austriak merret me arkeologji, ndërsa merret një-kohësisht me etnografi, folklor, gjuhësi. Hahn ka meritën se është i pari që përcaktoi vendndodhjen e Albanopolit të vjetër, në fshatin Zgërdhesh pranë Krujës, ku ai gjeti gërmadha muresh të lashta. Hahn është një shkencëtar i shquar, dashamirës i popullit shqiptar.


Para Dëgranit në varrezën e Kalasë së Dalmaces kishin bërë gërmime të herëpashershme thesarëkërkes të cilët mendonin se, sipas legjendës, ishte një pemë me gjethe të arta, por në vend të saj ata zbuluan varre të të vdekurve që u përkisnin shekujve VI-VIII.

«Në rrjedhën e poshtme të lumit Drin, pranë një fushe të vogël ndodhet fshati Koman... Por këtë fshat e kanë bërë të njohur rrënojat e një kalaje të moçme, rrënojat e Kalasë së Dalmaces, si e quajnë vendësit, dhe sidomos një varrezë e lashtë e zbuluar në një shpat mali, pranë saj. Kurse kulturën materiale, që u zbulua në malin e varreve, arkeologët e quajtën Kultura e Komanit... Tregimi ynë nis dhe me një gojëdhënë për një thesar të fshehur në malin e varreve. Midis dushqeve, që e mbulonin këtë mal, thuhej atëherë, kishte një pemë me gjethe të arta, në rrënjët e së cilës fshihej një thesar. Kjo gojëdhënë çoi në fshatin Koman thesarëkërkes të huaj. Në Koman ata nuk gjetën thesarin e gojëdhënës, por një varrezë të lashtë, në varret e së cilës u zbuluan sende të panjohura për ta. Dikush e lidhi këtë kulturë me pellazgët mitologjikë. Para disa vjetësh kishte pleq në Koman, që mbanin mend se në fillim të shekullit tonë patën ardhur në fshatin e tyre disa udhëtarë të huaj. Këta «mysafirë» sa vinin, ngjiteshin në malin e varreve, gërmonin, merrnin sendet që zbulonin në varret dhe pastaj largoheshin... Tregimi

---

1) J. G. Hahn, «Reise durch die Gebiete des Drin und Wardar», Viene 1876, f, 52-57.






6. Objekte nga varreza e Kalasë së Dalmaces (Muzeu Sen-Zhermen i Parisit).

vazhdon, por tani larg në Paris, Berlin dhe Romë, ku ishin dërguar sendet e marra në varrezën e Komanit.»<sup>1)</sup>

Sigurisht edhe Degranin e tërhoqi kjo legjendë që kishte në bazën e vet floririn. Të gjitha objektet e zbuluara ai ia dërgoi Muzeut Sen-Zhermen të Parisit dhe inventari i tyre sipas atij vetë është ky:

- 14 rathë të mëdhenj qafe, bronz,
- 400 rruaza të ndryshme, qelq,
- 8 byzylykë,
- 38 vathë e rathë vathësh, bronz dhe argjend,
- 6 zbukurime vathësh, argjend,
- 27 zbukurime, bronz,

1) S, Anamali, «Vazhdim i një tregimi për një zbulim arkeologjik», Drita, 30 maj 1971.



9. Objekte zbukurimi nga varreza e Kalasë së Dalmaces (Muzeu Sen-Zhermen i Parisit).

- 10 unaza, bronz,
- 1 unazë, argjent,
- 17 fibula, bronz,

- 1 broshë e rumbullakët,
- 2 sopata, hekur,
- 1 shpatë, hekur,
- 16 thika, maja heshtash dhe unaza.<sup>1)</sup>

Në librin e vet Dëgran boton edhe një fotografi të malit të varreve ku i ka bërë këto zbulime.<sup>2)</sup> Po Dëgran s'mjaftohet me varrezën e Kalasë së Dalmaces: ai bën eksplorime arkeologjike edhe në zonën e Mirditës dhe sidomos në qytetin e Durrësit dhe në Apoloni.

Dëgran shkruan:

*«Duke ditur, sepse gjithçka mund të merret vesh në një qytet të vogël oriental brenda një ore, që unë interesohesha për antikitetet që mund të gjendeshin, shumë banorë erdhën dhe m'u lutën që t'i vizitoja shtëpitë e tyre. Unë nuk pashë veçse kokat e disa statujave mjaft të rëndomta, për të cilat ma kishin ekzagjeruar vlerën».*

Dhe më poshtë vazhdon:

*«Këto gjetje nuk japin një ide të plotë, por megjithatë pak qytete të kësaj krahine janë të pasura me monumente antike sa Durrësi. Mjafton të gërmosh pak truallin për të mbjellë ose për të ndërtuar diçka dhe do të gjesh një numër të madh mbeturinash të kohërave të kaluara dhe në realitet janë gjetur shumë prej tyre, sipas atyre që kam dëgjuar, por interesimi për këto objekte asnjëherë nuk ka shqetësuar autoritetet dhe nuk kanë bërë asgjë tjetër veçse i kanë shkatërruar.»<sup>3)</sup>*

Duket qartë fytyra e dyfishtë e Dëgranit. Nga njëra anë ai «shqetësohet» për fatin gjoja tragjik të këtyre monumenteve, bile hedh dhe idenë e ngritjes së një muzeumi, por është po vetë ai që i grabiti po këto monumente.

1) A. Degrand, «Souvenirs. de la haute Albanie», Paris, 1901, f. 262.

2) A. Degrand, «Souvenirs...», f. 256.

3) A. Degrand, «Souvenirs...», f. 179-183.

Në Apoloni Dëgrani ka grabitur disa objekte, ndër-  
sa Ipen tregon se po atij i përkiste edhe një figurinë  
bronzi, ajo e një kali, që Dëgran e kishte gjetur në  
Vuksan — Lekaj.<sup>1)</sup>

Është interesant fakti që Dëgran do të na e bëjë  
të huaj një nga piktorët tanë më të njohur të tra-  
ditës, Kolë Idromenon, duke ia mohuar kombësinë  
shqiptare. Atëherë Kolë Idromenoja ishte një piktor  
i ri dhe kishte nisur të merrte një emër të mî-  
rë. Piktura e tij «Dy rrugët» që Dëgran e riprodhon  
në librin e vet ka rëndësi se aty gjejmë të pikturuara  
portretet e figurave historike, Peshkopit Asti dhe Bar-  
letit, historianit tonë të madh.<sup>2)</sup>

Pas Dëgranit shkon në Koman dhe gërmon në va-  
rrezën e Kalasë së Dalmaces «një i pasionuar» tjetër i  
arkeologjisë, konsulli austro-hungarez i Shkodrës Teo-  
dor Ipen, që edhe bleu nga thesarkërkues objekte të  
tjera të zbuluara nga kjo pikë arkeologjike.<sup>3)</sup>

Teodor Ipen bën dhe një eksplorim arkeologjik në  
rrethet e Shkodrës, në Marshej, Koplik, Fushë-Shtoj,  
Draç e Rash, Rrenc-Gajtan, Vuksan-Lekaj dhe tregon  
për një numër objektesh arkeologjike me vlera të ve-  
çanta prej të cilave edhe duhet të ketë grabitur.<sup>4)</sup>

Kalaja e Dalmaces tërhoqi vëmendjen e një vargu  
klerikësh, të cilët, të ngarkuar me misione nga Vatikani,  
erdhën në Shqipëri dhe u interesuan posaçërisht për

---

1) T. Ipen, «Sende romake dhe prejhistorike të gjetura në  
rrethin e Shkodrës», Kalendari i Veprës Pijore, nr. 29, 1922,  
f. 33-37.

2) A. Degrand, «Souvenirs...», f. 278.

3) Th. Ippen, «Denkmaler Verschiedener Altersstufen in  
Albanien», Wissenschaftliche Mitteilungen aus Bosnien und der  
Herzegowina, V. 10, Wien 1907, f. 16-22.

Th. Ippen, «Starine iz Albanije.» Sarajevo 1901 në separatni  
opsak iz Gllasnika zemljazok muzeja u Bosnji i Hercegovini  
f. 1-2.

4) T. Ipen, «Sende romake dhe prejhistorike të gjetura në  
rreth të Shkodrës», Kalendari i Veprës Pijore, nr. 29, 1922, f.  
33-37.



këtë varrezë dhe morën ç'mundën të mblihdnin gjatë vizitave të tyre të shkurtra në këtë trevë.

Gjithashtu jo më pak varreza e Kalasë së Dalma-ces tërhoqi vëmendjen e arkeologëve specialistë.

Dy vjet rresht (1899-1900) gërmoi aty parahistoriani Treger. Lënda arkeologjike e zbuluar prej tij është kjo:

### 1899

- Fibul, bronz,
- Aplikë rripi, bronz,
- Byzylyk me petë të gjerë, bronz,
- Dy rrathë bronzi (njëri i përbërë prej dy rrathësh të bashkuar),
- Temthore, bronz,
- Fragment spiraleje, bronz,
- Dy fibula, hekur,
- Katër copë rruaza, qelq,
- Një latushë, hekur.


### 1900

- Fibul, bronz,
- Qafore, bronz, me varse me trajtë rruzulli të çarë,
- Katër unaza, bronz,
- Varse në formë spirance, bronz,
- Vath me trup në formë trapezi të ngushtuar dhe në pjesën e poshtme në formë ylli, bronz,
- Paftë e veçuar e po këtij tipi vathi,
- Thikë hekuri,
- Majë shigjete, hekur,
- 19 rruaza qelqi të tipeve të ndryshme.<sup>1)</sup>


Pas vizitës së Tregerit (ai të gjithë këto objekte ia dorëzoi Konigl Museum fur Volkerkunde të Berlinit), kjo pikë e rëndësishme arkeologjike dëmtohet rëndë. Sendet e gjetura këtu shiteshin në Shkodër. Disa prej këtyre objekteve bien në dorë dhe të dije-

---

1) P. Traeger, «*Mittheilungen und funde aus Albanien*», në *Zeitschrift fur Ethnologie* 1900, f. 43-51: P. Traeger, «*Bergabnis -Platze und Tumuli in Albanien und Macedonien*», *Verhandlungen der Berliner anthropologischen Gesellschaft*, 1901, f. 43-47.



10. Objekte nga varreza e Kalasë së Dalmaces (Muzeu i Berlinit).



11. Varr i grabitur nga Kalaja e Dalmaces.

tarit Franc Nopça. Ai pati eksploruar vetë disa varre të Komanit, por, sikurse shkruan vetë, i kishte gjetur të grabitura. Vetëm në fund të gërmimit të tij ai ndeshi në një varr të paprekur me inventarin përkatës.<sup>1)</sup>

Varreza e Kalasë së Dalmaces e cilësuar si një nekropol «misterioz» është grabitur në mënyrë mizore nga të huajt. Objekte të rëndësishme për historinë e shqiptarëve si vazhdues të drejtpërdrejtë të ilirëve, që u gjetën në këtë varrezë përbënin një burim të pasur dokumentar material, po ato u shpërndanë përkatësisht në Francë, në Itali, në Gjermani e gjetkë. Të bësh inventarizimin e plotë të këtyre objekteve është e pamundur. Vështirësitë shtohen sidomos për faktin se shumë thesarëkërkues anonimë, pasi kanë bërë gërmime në varrezën e Kalasë së Dalmaces, janë endur dyerve të muzeumeve të Evropës (dhe jo vetëm të Evropës) me duart e mbushura me objekte të zbuluara në këtë trevë, duke shitur kështu fragmente të çmuara historie të një populli me tradita të lashta, po që në këto vite jetonte nën zgjedhën e shtypësve të huaj.

Bujë të madhe kishte bërë në vitet shtatëdhjetë të shekullit të kaluar nëpër qarqet arkeologjike të Evropës zbulimi i një statuete bronzi në fshatin Gur i Zi në afërsi të Shkodrës. Ajo do të quhej me një emër disi mondan: «Një damë antike shqiptare».<sup>2)</sup>

---

1) Franc Nopsca, «*Archaeologisches Nordalbanien*,» ne Wissenschaftliche Mittheilungen aus Bosnien und der Herzegovina, vell. 11, Vien 1909, f. 86-87.

2) A. Dumont. «*Bronze archaïque trouve a Gour i Zi, en Albanie*, në Revue archeologique nouvelle», XXIV, 1872, f. 1-3 dhe me një vizatim nga M. Chaplain; idem., tabela XV.

Këtë artikull Dymont e përsëriti me disa shtesa dhe shënime në «*Melanges d'Archeologie et Epigraphie*», Paris 1892, f. 42-44, viz. XI.

Solomon Reinach, «*Repertoire de la sculpture Grecques et Romaines*», II, Paris 1909, nr. 7, f. 422, 423, 552.

De Rider, «*Catalogue des Bronzes*», nr. 140, f. 27, viz. 16.

«*Guides des Bronzes*», nr. 140, f. 47, fig. 12 me dy ilustrime me fotografi.

Luigi Ugolini, «*Albania Antica*», I, f. 15, fig. 14.





13. E ashtuquajtura «Dama antike shqiptare»  
(Luvër)

Statueta paraqet një grua me një veshje tepër të veçantë. Ajo mban një fustan me grykë të zbuluar dhe me mëngë të shkurtra në fundin e të cilave ka disa motive të thjeshta. Fustani është i gjatë dhe i ngushtë

dhe arrin pranë fundit të këmbëve, në të cilat ka mbathur opinga lëkure të shtrënguara me lidhëse. Sipër fustanit ajo ka vendosur një përparse të ndarë me disa breza me pesë radhë motivesh dekorative. Në tre të poshtmit mund të dallojmë si motive stilizime të thithkave, ndërsa në dy të sipërmit dallojmë disa si luspa peshku.

Gruaja ka flokë që i lëshohen deri në shpatulla dhe me kaçurëla të rregullta. Mbi kokë ajo ka vendosur një kalothos, në një formë pak si të çuditshme, që zgjerohet gradualisht duke u ngjitur dhe që përfundon pothuaj në një disk. Në qafë ka vendosur dy palë rruaza në formë sferike. Me dorën e djathtë gruaja mban një ojnohe dhe me të majtën një kyliks të vogël. (Duket që hedh verë nga ojnoheja në kyliks).

Skulptura ka rëndësi se shumë tipare të kësaj veshje janë trashëguar gjer në kohën tonë në këtë trevë, ku ajo është gjendur. Pra kemi të bëjmë me një vazhdimësi veshjeje mbi njëzetshekullore nga ilirët te shqiptarët.

Kjo statujë që u ble prej një fshatari nga konsulli italian M. Perrod, në vitin 1881 përfundoi në Muzeun e Luvrit.

S'do të kalojnë as dy dekada dhe përsëri do të shpërthejë një sensasion arkeologjik. Edhe këtu në vorbullat e allishverisheve do të shohim konsujt e huaj. Është fjala për thesarin prej ari të zbuluar në fshatin Vrap të Peqinit.<sup>1)</sup>

Ky thesar u gjet rastësisht nga një fshatar i varfër në vitin 1902 dhe përbëhej nga këto objekte kryesore:

Një kupë e artë me katër buste grash që personifikonin qytetet Qipro, Aleksandri, Konstantino-

---

1) Jozef Strzyowski, «Altai — Iran und die Völkerwanderung», Laipciq, 1917, f. 1-40.

S. Anamali «Një thesar mesjetar i zbuluar në Shqipëri», Ylli, nr. 12, 1963.



13. Enë nga thesari i fshatit Vrap.



14. Enë nga thesari i fshatit Vrap.



16. Enë nga thesari i fshatit Vrap.

15. Enë nga thesari i fshatit Vrap.

pol dhe Romë, tetë enë prej ari me zbukurime zogjsh, luspash, dredhash, palmash, kusi prej argjendi, 50 pajime të ndryshme prej ari, tokëza, gjuhëza, aplike, copra teli, shufra dhe thumba prej ari.

Pesha e përgjithshme e thesarit arrinte 7 kg e 253 gr, nga të cilat objektet e arta peshonin 5 kg e 815 gr ndërsa ato të argjendit 1 kg e 438 gr.

Enët në përgjithësi kishin përmasa mesatare dhe lartësia e tyre nuk i kalonte të 20 cm.

Në vitin 1907 thesari nuk gjendej më në Shqipëri. Pat ndërhyrje të mëdha nga konsujt e Francës, Austro-Hungarisë dhe Italisë të vendosur në qytetin e Durrësit, të cilët, me mënyrat e tyre të stërholluara, arritën ta nxjerrin atë jashtë vendit, duke u bërë ndërmjetës për shitjen e tij në Evropë dhe Amerikë.

Një kupë e artë, me katër bustet e grave, që përfaqësonin qytetet Qipro, Aleksandri, Konstantinopol dhe Romë, iu dërgua dhuratë nga mytesarifi turk i Durrësit, Stambollit. Një tjetër u shit në Trieste dhe përfundoi në Paris; 39 objekte u dërguan në Nju-Jork dhe u blenë nga miliarderi amerikan Pierpont Morgani, të tjerat humbën adresë dhe u bënë pronë e blerësve anonimë. Kështu që ky thesar u shpërnda nëpër muzetë e Stambollit, Parisit dhe Nju-Jorkut.

Në revistën «Agimi» botohet një shkrim ku bëhet fjalë për tre objekte të këtij thesari.

*«Në pranverën e vitit 1902 qeveria turke e Tiranës u mundua të shtinte në dorë një kupë të larueshme me stolina të çmueshme. Si u mor vesh kjo punë, konsulli*



17. Enë nga thesari i fshatit Vrap.



*austriak i atëhershëm i Durrësit, Remi Von Kuratovski, mujtë me caktue burimin si vijon: një katundar shqiptar prej Vrapit, që është një fshat i rrethit të Peqinit, tuj këthe dheun me parmënde, ndeshi papritë në një kazan remi. Si e nxori prej dheut pa u interesuar aspak se ç'kishte brenda, bani treg me tre shqiptarë të atyre rretheve dhe ia shiti për tri me-xhide.<sup>1)</sup>*

Artikulli i përshkruan këto visare si të gjetura përkatësisht në Vrap të Peqinit (1902), në Durrës (dhjetor 1904) dhe në Tiranë (1906-1907). Por objektet kanë një unitet arkeologjik dhe kohor, ato u përkasin shekujve 7-9 dhe është e natyrshme që janë pjesë e një thesari të vetëm, atij të fshatit Vrap. Në këtë ngatërrim ne duhet të shohim një pjesë të odisesë të këtij thesari, pa kaluar kufijtë e vendit tonë.

Studimi i thesarit të Vrapit filloi atëherë kur ai u bë pronë e muzeve të huaja. Dijetarët e kuptuan se ky ishte një zbulim me rëndësi të madhe arkeologjike dhe thesari qëndronte përkrah gjetjeve më të njohura të këtij lloji të bëra në Evropën Juglindore. Megjithatë të depërtosh në studimin e tij do të thotë të depërtosh në «Labirintet e Knosit», sepse objektet e marra fshehtazi i ka mbuluar një shtresë e trashë enigme. Botimi i Jozef Stryovskit është tepër i pjesëshëm dhe aspak i plotë.

Ndërhyrjen e konsujve të ndryshëm të vendosur në Shqipëri në këto vite do ta ndiejmë gjithmonë pas ndonjë zbulimi të ri arkeologjik. Kështu që fijet e interesave të tyre do të zgjaten, gërshetohen e ndërthuren herë në dritë të dobët, herë në errësirë të plotë, duke i shërbyer një qëllimi të vetëm: *grabitjes*.

Ngjarjet do të ripërsëriteshin me zbulimin e sarkofagut të famshëm të Dyrrahut. Ky sarkofag prej mer-

---

1) «*Agimi*», vjeti i parë, nr. 12, prill 1920, f. 195, «Tri visare të çmuarshme në Shqipëri.»

meri u zbulua në shtator të vitit 1909 dhe i përket shekullit II të epokës sonë. Ai u gjet i plotë dhe i mbuluar me një kapak të gdhendur edhe ky në mermer. Brenda u gjetën stoli ari, argjendi, gurë të çmuar, një shpatë, përkrenarja dhe heshta. Dukej që sarkofagu i përkiste një përfaqësuesi të parisë së qytetit.

Nëpër faqet e sarkofagut ishin gdhendur në relief dhjetëra figura të paraqitura plot forcë dhe lëvizje. Artisti kishte gdhendur në mermer skena beteje dhe ngjarje nga mitologjia. Meqë në njërën anë të kapakut ishte paraqitur skena e vrasjes së derrit Kalidon nga djaloshi Meleager (subjekt ky nga mitologjia), ai ka marrë emrin sarkofagu i Meleagrit.

Sarkofagu u vendos në qendër të qytetit. Përfaqësuesit konsullorë të Austro-Hungarisë ofruan këtë herë një shumë kolosale, një milion korona. Por Porta e Lartë (tashmë kishte nisur interesi i grumbullimit të objekteve shqiptare edhe nga Turqia) dha urdhrin që sarkofagu të dërgohej në Stamboll dhe të vendosej në Muzeumin Arkeologjik të qytetit, ku gjendet njëkohësisht edhe një fragment tjetër — sarkofagu po nga Durrësi, një kokë e mrekullueshme femre nga Apolonia, si edhe shumë objekte të tjera.<sup>1)</sup>

Lui Rober njofton se objekte shqiptare të gdhendura në relief gjenden edhe në Muzeumin e Ankarasë.

Një këmbanë e Krujës e kohës së Skënderbeut (viti 1462) që ishte zbuluar në fillim të këtij shekulli nga konsulli i Austro-Hungarisë Kviatovski që dërguar në Vjenë. Por ky konsull u tregua i drejtë dhe në janar të vitit 1924 këtë objekt të rëndësishëm e dërgoi përsëri në Shqipëri.<sup>2)</sup>

---

1) G. Mendel, «*Catalogue des sculptures grecques, romaines et byzantines*,» Constantinople, II, 1914, nr. 330, f. 88. Idem, Vol. I, 1912, nr. 4, f. 5-12, idem, nr. 5, f. 12-14.

Macridi Bey, «*Jarbuch, D. K. Archeologische Inst.*» XXV, 1910, kolona, nr. 143, nr. 1.

2) «*Veprimj e Biblijeotekës Kombëtare gjatë vitit 1930*», Tiranë, 1931, f. 17.



18. Sarkofagu i Durrësit, pamje përballë, (Muzeu Arkeologjik i Stambollit).

Në Muzeumin Kombëtar të Armëve në Gjirokastër janë edhe pesë armë të vjetra (tre kobure dhe dy hanxharë) që i ka dhuruar miku i vendit tonë Karl Buh-berger.

Në letrën e tij ai shkruan:

*«Me anën e kësaj letre kam nderin t'i dërgoj muzeumit tuaj të armëve, themelimin e të cilit e mësova nga revista e ilustruar «Shqipëria e Re» (nr. 1. 1973), një dhuratë prej armëve të vjetra, tre kobure dhe dy hanxharë me prejardhje autentike shqiptare. Këto armë kanë mbetur nga një koleksion të cilat unë më 1912, kur kam shërbyer si atashe në konsullatën e Austro-Hungarisë në Shkup, kam patur nderin t'i mbledh në fshatrat shqiptare të vilajetit të*




*Kosovës, koleksion i cili gjatë transportimeve të shpeshta për fat të keq është reduktuar në këtë numër dhuratash.»*

E më poshtë, duke shprehur respektin dhe dashurinë për vendin tonë, autori i letrës përfundon:

*«Pra me një ndjenjë të një dashurie të thellë e të singertë dhe admirim për Shqipërinë e për popullin e saj heroik kam nderin dhe kënaqësinë të dërgoj këtë dhuratë në muzeumin e armëve në Gjirokastrë për të kontribuar në koleksionin e armëve të vjetra shqiptare dhe për të shprehur simpatinë për qytetin e bukur të Gjirokastrës...»<sup>1)</sup>*

1) Kopja e kësaj letre është në Muzeun kombëtar të armëve në Gjirokastrë.





19. Sarkofagu i Durrësit, pamje anësore (Muzeu Arkeologjik i Stambollit).



20. Fragment sarkofagu nga Durrësi (Muzeu Arkeologjik i Stambollit).



21. Këmbanë e Krujës e kohës së Skënder-  
beut.



22. Statujë bronzi nga Shqipëria Veriore, Muzeu Britanik.

Ndërsa armët e heroit të blera motit nga perandori i Austrisë Maksimiliani vazhdojnë të qëndrojnë në Muzeumin e Belvederes në Vjenë, e që dihet që janë thesari i thesareve tona historike. Pak na ka marrë





23. Shpatë bronzi nga Shkodra (Muzeu Britanik).

Austria që nuk i gjen me vend t'i dërgojë përsëri në Shqipëri?

Një arkeolog i njohur thotë për Shlimanin që zbuloi dhe grabiti Trojën: «Ai hyri si një elefant në një dyqan farfurinash». Me plot të drejtë ne mund të themi për përfaqësuesit e ndryshëm konsullorë në Shqipëri se ata nuk e ndanë zanatin e tyre nga arkeologjia: ata hynë si një kope elefantësh në një dyqan farfurinash. Me gërmimet e tyre pa asnjë lloj kriteri shkencor, ata shkatërruan shtresat, dëmtuan rëndë shumë objekte me vlerë të madhe historike, duke i bërë një dëm kolosal kulturës materiale të popullit tonë.

## GRABITJET E PASURIVE ARKEOLOGJIKE TË SHQIPËRISË NGA DISA AUSTRIAKË DHE SERBË

Nëntoka shqiptare, aq e pasur me monumente të lashtësisë, nuk ishte vetëm objekt i kërkimeve të diletantëve të arkeologjisë, përfaqësuesve të ndryshëm konsullorë, apo thesarkërkuesve, por edhe e arkeologëve specialistë.

Pas Leon Hezejt në vitin 1893 kishte botuar librin e vet të kërkimeve arkeologjike për Ilirinë një nga arkeologët më të dëgjuar Artur Evans.<sup>1)</sup>

Artur Evans lindi më 1851 dhe u arsimua në Oksford dhe në Gotingen në shkencat historike. Gjatë viteve 1873-1874 bëri një udhëtim në Finlandë dhe më 1875 u mor me studimin e arkeologjisë dhe të etnografisë së Ballkanit. Më 1893 ai nisi gërmimet në Kretë dhe bëri zbulime të një rëndësie të jashtëzakonshme. Nga ky ishull me kulturë të lashtë (ai zbuloi Pallatin e Knosit, vepër unike, gjigante, e mbushur me afreske të mrekullueshme) Evans grabiti shumë monumente të çmuara, objekte prej ari dhe argjendi dhe që tashmë ndodhen në Muzeun Britanik, duke vazhduar atë rrugë që kishte nisur në fillimet e karrierës së vet arkeologjike edhe në Shqipërinë Veriore.

---

1) A. J. Evans. «*Antiquarian researches in Illyricum*» (Pas I and II) Weistminster, 1883.

Në Muzeun Britanik krahas disa mobiljeve dyqind-vjeçare të gdhendura në dru, tavanesh të dekoruar ka shumë objekte arkeologjike nga Shqipëria dhe, sigurisht, janë edhe nga ato objekte që i ka dërguar atje Artur Evans. Ky arkeolog ka grabitur edhe një thesar monedhash të Shkodrës, Rizonit, Lezhës, Durrësit dhe Apolonisë, që ishte gjetur në katundin Selcë të Shkodrës.<sup>1)</sup>

Evans mori dhe një shpatë bronzi të gjetur në Shkodër, por vlera të veçanta ka një figurinë bronzi e shekujve 4-3 para erës sonë. Megjithëse në përmasa të vogla, ajo ka vlera të çmuara historike dhe artistike. Një grua (me sy të mëdhenj, shumë të mëdhenj) është në një pozicion vallëzimi. Këmbën e majtë e ka të hapur. Po kështu të hapur dhe pak të përkulur ka edhe këmbën e djathtë, ndërsa dy duart janë të ngritura lart. Gruaja është plot lëvizje dhe gjallëri në përshtatje me vallen që po luan. Të bie në sy fundi i saj në formën e xhubletës, ndërsa pjesët e tjera të kësaj veshje mungojnë. (E ngjashme me figurën e gruas së vizatuar të Klishevacit).

Figurina ka vlera se ruan të fiksuar në bronz një tip të veshjes sonë të trashëguar brez pas brezi, të xhubletës, origjina e së cilës humbet në brymë të shekujve të shkuar.

Evans boton gjithashtu edhe një mbishkrim nga malësitë e Shkodrës dhe flet për gërmadhat e një rruge të lashtë në këtë krahinë<sup>2)</sup>

---

1) «Numizmatice cronicle», vol. XX (1880) f. 277 e vazhdim:

H. Ceka. «Zbulimi i një thesari monetash antike në Durrës», Buletini i Shkencave Shoqërore, 1958, nr. 1, f. 145.

2) Evans shkruan: «I pari i françeskanëve më bëri të njohur se ka qenë në Hot e se aty gjenden mbishkrime romake dhe aty afër janë rrënojat e një ndërtese të lashtë, shumë të madhe, që i ngjan një tempulli gjithashtu një mbishkrim gjendet brenda në një shtëpi». Dhe Evans boton mbishkrimin që përmban emrin ilir ANAE.

Këtë mbishkrim e gjejmë të botuar edhe nga Ipen.



Gjatë Luftës së Parë Botërore erdhën në Shqipëri dy arkeologë austriakë, Prashniker dhe Shober, që bëjnë dhe gërmime arkeologjike. Nis kështu me një intensitet të madh një periudhë e re: *Grabitja sistematike e monumenteve arkeologjike të nëntokës shqiptare nga arkeologët profesionistë.*

Ata duke fshehur qëllimin e vet të vërtetë në librin e tyre që e botuan në vitin 1919 thonë se kishin ardhur në Shqipëri për ta studiuar këtë vend të pasur me antikitetet.<sup>1)</sup>

Por realiteti ishte krejt ndryshe. Si Prashniker ashtu edhe Shober ishin përfaqësues të një fuqie imperialiste, që kishte synime grabitqare ndaj vendit tonë, të Austro-Hungarisë. Dhe këto synime, krahas grabitjeve natyrore (në Shqipëri erdhën gjeologët e shouar si Veters, Shtejnmetts, Cvijiç, Fric etj.) përmbledhnin, natyrisht, dhe grabitjet e pasurive arkeologjike.

Në këto vite të vështira pushtuesit austro-hungarezë kanë dërguar në vendin tonë një mizëri shkencëtarësh, që kanë rrëmbyer çdo gjë që e kanë parë me vlera të mëdha arkeologjike, historike dhe etnografike. Në fillim të shtatorit të vitit 1917 kishte ardhur në Shqipëri vetë rektori i Universitetit të Vjenës. Heger, për të bërë kërkime etnologjike në Mirditë.<sup>2)</sup> Edhe më parë, në pranverë të vitit 1916, ishte dërguar një ekspeditë e veçantë e përbërë nga specialistët Ignaz Dorth, historian, Adolf Mahr, zoolog, dr. Arnold Penter dhe dr. Hans Zerny.<sup>3)</sup> Ndërsa Jakoviq kishte mbledhur

---

1) C. Praschniker und A. Schober, «*Archaologische Forschungen in Albanien und Montenegro*», Wien 1919.

2) «*Posta e Shqipërisë*», 10 tetor 1917,

3) Po aty, 22 maj 1918,

nëpër Shqipëri shumë objekte të bukura, veshje burrash dhe grash dhe i kishte nisur në Vjenë nën kujdesin e dr. Haberland që ishte marrë me studimin antropologjik të shqiptarit, për t'i vendosur në Muzeun e Artizanatit. Për këto objekte shkroi edhe shtypi vjenez.<sup>1)</sup>

Shtypi vjenez do të shkruajë edhe për mjaft objekte arkeologjike dhe etnografike të Ekspozicionit Ballkanik të Universitetit të Vjenës, ndër të cilat 75 veshje nga krahinat e ndryshme të Shqipërisë (megjithëse shumë gjëra kishin mbetur rrugës nga bora e madhe) dhe disa objekte arkeologjike, veçanërisht për një ene bronzi nga Vlora, tepër e ngjashme me vozat etruske, që pastaj do t'i rezervohej një vend i posaçëm në muzeun Perandori Karl të Vjenës.<sup>2)</sup>

Prashniker dhe Shober në bashkëpunim me një pjesë të specializuar të ushtrisë gjurmojnë me kujdes të gjitha pikat arkeologjike të Shqipërisë me një qëllim të caktuar: të grabisin objektet më me vlerë. Kjo vihet re sidomos në udhëtimin e dytë që Prashniker bëri në Shqipëri, ku grumbulloi shumë monumente, të cilat i dërgoi në Durrës dhe në Lushnjë, gjoja për të themeluar një muzeum antik, por në të vërtetë me qëllim që të transportoheshin në Austri.

---

1) «*Posta e Shqipërisë*», 17 nëntor 1917.

2) «*Posta e Shqipërisë*», 16 janar 1918.

Ekspozita shoqërohej edhe me piktura nga Shqipëria të Fainrih e Leopold Forstner me pamje shtëpish karakteristike, portrete malësorësh. Gjithashtu nga 30 prilli gjer më 2 maj të po të këtij viti në Shkodër kishin hapur një ekspozitë pikturë piktorët e kuartierit të Luftës Horovitz, Pravotnizki, Beszdes, me skica, portrete, pejzazhe etj. Kjo e bën edhe më të plotë kuadrin e interesimit të gjithanshëm të pushtesve austro-hungarez<sup>2)</sup> ndaj vendit tonë.






24. Stele nga Fieri, grabitur gjatë Luftës së Parë Botërore nga austriakët.



25. Kokë djaloshi nga Apolonia, grabitur gjatë Luftës së Parë Botërore



26. Skulpturë nga Apolonia, grabitur gjatë Luftës së Parë Botërore



27. Bronzinë nga Radoshtima, grabitur gjatë Luftës së Parë Botërore.

Kjo objektë është një maskë bronzë, e cila është gjetur në Radoshtima, në jug të Shkupit, në vitin 1913.

- Këtë maskë e ka gjetur në vitin 1913, gjatë Luftës së Parë Botërore.

- Për më tepër, kjo maskë është e njëjta me maskën e gjetur në Radoshtima, në vitin 1913.



28. Kokë gruaje nga Fieri, grabitur gjatë Luftës së Parë Botërore.



29. Bust nga Klosi, grabitur gjatë Luftës së Parë Botërore.

Këto objekte, sipas vetë Prashnikerit, janë:  
— Kokë e bukur e një djaloshi nga Ardenica,  
— Portret i një gruaje me mbishkrim, marrë nga një kishë e Gradishtës,



- Kokë tjetër gruaje, marrë nga një kishë e Fierit,
- Portret i një burri me mjekër, marrë nga Manastiri i Pojanit,
- Portret i një burri, marrë nga Apolonia, pranë murit jugor,
- Statujë e vogël e një vajze, marrë nga Rado-shtina,
- Fragment, tors i një gruaje, marrë nga kisha e Libofshës,
- Fragment i një statuje burri, madhësi mbinatyrore, marrë nga Apolonia,
- Statujë e një burri të veshur, po nga Apolonia,
- Herme e një të riu, marrë nga Manastiri i Pojanit,
- Fragment i një statuje burri — madhësi mbinatyrore, marrë po nga Manastiri i Pojanit,
- Fragment tjetër i një statuje, përsëri nga Manastiri i Pojanit,
- Statujë e një burri të veshur, Manastiri i Pojanit,
- Statujë e një burri nga Bylisi,
- Fragment i një statuje gruaje, Manastiri i Pojanit,
- Stele, marrë nga nekropoli në Kryegjatë,
- Fragment i një guri varri, nga Manastiri i Pojanit,
- Fragment i një guri tjetër varri, nga Apolonia,
- Reliev mortor, marrë nga kisha e Gradishtës,
- Reliev mortor, nga Klosi,
- Gur varri i dy bashkëshortëve, marrë nga shkolla femërore në Fier,
- Gur varri, përsëri i dy bashkëshortëve, marrë nga kisha e Hoxharës,
- Gur varri, marrë nga Manastiri i Pojanit,
- Gur varri, marrë nga Apolonia,
- Fragment i një guri varri, gur tjetër varri, fragment i një guri varri, marrë nga kisha e Ballshit me mbishkrimin e emrit ilir Epikad.
- Gur varri, marrë nga kisha e Kurjanit.

- Fragment i një guri varri, marrë nga rrenojat e Manastirit të Ballshit,

- Reliev varri i një çifti bashkëshortor, marrë po nga rrenojat e Manastirit të Ballshit,

- Gur varri, nga rrenojat e Manastirit të Ballshit,

- Reliev, marrë nga kisha e Libofshës,

- Reliev votiv, zbuluar në gërmimet e bëra në Apoloni,

- Reliev nga kisha e shën-Trifonit,

- Fragment metopi me relief, nga Manastiri i Havaleas,

- Tri pjesë të një relievi nga Manastiri i Pojanit,

- Figurë e një sfinksi nga Kryegjata,

- Kokë luani nga kisha e Gradishtës,

- Kapitele të stileve dorik, jonik dhe korintik,

- Dy fragmente të një relievi, nga kisha e Petovës,

- Fragment relievi, nga Manastiri i Pojanit,

Prashnikeri boton edhe mbishkrimet e famshme nga Ballshi, tashmë të humbura, që bëjnë fjalë për sulmet normane.<sup>1)</sup>

Një vapor që ishte ngarkuar me një pjesë të këtyre objekteve u mbyt pranë brigjeve shqiptare, megjithëse objekte të tilla si stela e Parmeniksit, një portret i një gruaje nga Durrësi, të grabitura prej tij, tashmë mbahen si nga visaret më të mira të Muzeumit historik të artit të Vjenës.<sup>2)</sup>

Është interesant fakti se Prashniker dhe Shober trajtojnë edhe problemin e grabitjes së monumenteve arkeologjike nga Durrësi prej pushtuesve serbë dhe u bëjnë atyre një kritikë të rreptë(!) Kështu që grabitësi akuzon grabitësin.

---

1) C. Praschniker, «Muzakhia und Malakastra», Wien, 1920, f. 134-203.

2) Stela e Parmeniksit ndodhet në «Kunsthistorischen Muzeum» (muzeun historik të artit).



30. Stela e Parmeniskut (Muzeu historik i artit, Vjenë).



31. Portret gruaje nga Durrësi (Muzeu historik i artit Vjenë).



prej serbëve<sup>1)</sup> merret Balduin Sara me artikullin e tij «Antika nga Durrësi»<sup>2)</sup>

Sara shkruan:

«Si plotësim i kërkimeve arkeologjike të Prashnikerit dhe të Shoberit në Shqipëri... e antikave të dërguara nga Durrësi, të cilat u dërguan më 1913 në Muzeun Nacional të Beogradit, në bazë të akteve muzeale dhe inventarit nr. 2566 ndodhen këtu akoma dhe dy mbishkrime nga Durrësi dhe një relief i vogël... të cilat u rrëmbyen nga muri i qytetit të Durrësit prej hordhive serbe dhe u dërguan në Beograd.»<sup>3)</sup>

Balduin Sara tregon edhe për një altar me mbishkrim të kopjuar që nga Kiriaku i Ankonës dhe të lënë në harresë nga arkeologët gjatë shekujve, për një mbishkrim të kohës së perandorit Adrian, për një relief të Panit me tri nimfat dhe bën fjalë për stele të Aristodamit, e ardhur po nga Durrësi (që tashmë kishte humbur) dhe për kokën prej mermeri të djaloshtit të botuar nga Prashniker, që edhe kjo kishte humbur.<sup>4)</sup>

---

1) Po në vitin 1913 nga malazezët grabitet në Shkodër një muzeum i tërë. Ky muzeum i ngriur nga Bushatlliu në Kalanë e Shkodrës ishte i pajisur me llojet e armëve të vjetra, me flamuj të ndryshëm, materiale dokumentare, skica dhe grafika të piktorëve vendës. Në Muzeun Etnografik të Sarajevës ruhen disa nga këto armë të grabitura nga ky muzeum. Ndërsa në Kalanë e Peqinit serbët grabitën tavanet e gdhendura të sarajeve të saj.

2) Balduin Sara, «Antiken aus Durazzo», në Jereshefte des Osterreichischen Arch. Institutes, Wien 1926, nr. XXIII, f. 240-246.

3) Po aty.

4) Balduin Sara, «Antiken aus Durazzo», në Jereshefte des Osterreichischen Arch. Institutes, Wien 1926, nr. XXIII, f. 240-246.



Shumë kohë më parë se Prashniker dhe Shober, në vitin 1900 kishte ardhur në Shqipëri Karl Paçi, profesor i Universitetit të Vjenës, i specializuar në degët etnologji, histori dhe arkeologji, që për dy muaj rresht shëtiti viset shqiptare nga Myzeqeja në Berat e Mallkastër, gjithë bregdetin nga Semani në Himarë. Ai gjithashtu krahas studimeve të objekteve të sipërfaqes bëri dhe gërmime arkeologjike dhe pas katër vjetësh botoi librin e tij «Sanxhaku i Beratit në Shqipëri».4)

Në nëntor të vitit 1917 Karl Paçi lëviz përsëri nëpër Shqipëri, nëpër krahinat jugore të vendit tonë, po këtë herë i shoqëruar nga një gjeneral, Korculen fon Karl.2)

Karl Paçi mbahet edhe si themelues i muzeut të parë arkeologjik shqiptar, të ngritur në Tiranë, në vitin 1920, pas Kongresit të Lushnjës.

Lufta e Parë Botërore që plot trazira dhe turbullira të mëdha për fatet e kombit tonë, që gjithashtu një arenë përpjekjesh nga ushtritë pushtuese, për të grabitur pasuritë natyrore dhe arkeologjike.

Në një shkrim të botuar për Apoloninë, në këto vite, lexojmë:


*«Kurrë një dam tjetër, mos me pasë pësue Shqipëria e ngratë prej luftës botërore, mjaft asht dami i vjetërsinave të Pojanit q'i kanë grabitë».*

---

«Përveç këtyre dy mbishkrimeve u sollën në Beograd në atë kohë prej antikiteve gjithashtu një relief i vogël që paraqiste Panin me Nimfat» (fig. 40, f. 240-246); «Një gur varri me mbishkrim greqisht, që në inventarin e Beogradit ndodhet me numrin 2856, i ardhur nga Durrësi nuk gjendet më»... «Më në fund është për t'u përmendur që koka prej mermeri e publikuar nga Prashniker sot është zhdukur për fat të keq. Në ekspozimet e reja të Lapidariust të Beogradit ajo nuk është gjetur më».

1) Carl Patsch, «Das Sandschak Berat in Albanien», Wien 1904.

2) «Posta e Shqipërisë», 3 dhe 21 nëntor 1917.



37. Ndërtesa e Muzeut Kombëtar, themeluar në vitin 1920.

E më poshtë artikullshkruesi tregon për ushtarët pushtues që u janë vërsulur mureve të Manastirit të Pojanit, duke grabitur njeri pas tjetrit gjithë monumentet e murosura. Kjo gjë ndodhte gjithkund. Ushhtarët, të drejtuar nga arkeologët Prashniker dhe Shober, hiqnin ç'të gjenin nëpër mure, nëpër të gjitha kishat dhe manastiret që përmbanin objekte arkeologjike.

Veprime të tilla të ngjashme kryen edhe forcat italiane të pushtimit dhe ato franceze që ishin dislokuar në zonat e Shqipërisë së Jugut.

Në vitin 1920 një arkeolog italian kishte gërmuar në Çukën e Ajtoit dhe kishte marrë disa objekte me vlerë. Ndërsa ushtarët francezë kishin marrë shumë vepra



## MISIONI ARKEOLOGJIK ITALIAN, GRABITJA NË MASË E PASURIVE ARKEOLOGJIKE

Në vitin 1927, në vazhdim të marrëveshjeve të tjera skllavëruese me fashizmin italian, që bëri qeveria e Ahmet Zogollit, u lidh marrëveshja arkeologjike ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë. Me anë të kësaj marrëveshje misioni italian fitonte të drejtën ekskluzive të bënte gërmime arkeologjike në prefekturat e Elbasanit, Dibrës, Vlorës, Gjirokastrës, Korçës dhe Tiranës.<sup>1)</sup>

Kjo ishte një ëndërr e vjetër e Italisë imperialiste. Edhe më parë qeveria italiane ishte shqetësuar, se të tjerë të huaj kishin nisur gërmime arkeologjike në Shqipëri dhe këtë shqetësim qarqet e ndryshme reaksionare italiane e kishin shprehur edhe në shtyp.<sup>2)</sup>

Në aktin e kësaj marrëveshje, ndër të tjera, shkruhej se qëllimi i saj ishte që t'u jepej një «zhvi-

---

1) Gazeta zyrtare, 3.I.1928. Kjo marrëveshje është miratuar me ligjin nr. 6, dhjetor 1927 «Mbi pranimin e marrëveshjes ndërmjet Shqipërisë e Italisë përmbi studime e rrëmime arkeologjike në Shqipëri».

2) Një publicist italian në atë kohë bënte pyetjen: «Në një kohë kur Austria dërgon misione arkeologjike në Shqipëri, ç'bën Italia?». Studime historike, 1971, 2, f. 178.

llim i vlefshëm» raporteve «miqësore», «të mira» që ekzistonin ndërmjet Italisë dhe Shqipërisë nga pikëpamja shkencore dhe veçanërisht arkeologjike.<sup>1)</sup> Fshihej këtu qëllimi kryesor që ishte grabitja e këtyre pasurive arkeologjike.

Megjithëse marrëveshja u nënshkrua në vitin 1927, qeveria shqiptare i kishte dhënë leje arkeologut fa-shist Luigji Ugolini që të vinte në Shqipëri shumë kohë më parë. Në pranverën e vitit 1924, i ngarkuar prej Muzeumit Nacional Roman, ai kishte ardhur këtu për të bërë kërkime arkeologjike mbitokësore në bregdetin e Shqipërisë dhe rezultatet e kësaj ekspedite ai i publikoi në librin e vet «Shqipëria antike».<sup>2)</sup>

Në këtë vëllim, Luigji Ugolini bën një përshkrim të shumë monumenteve të Shqipërisë, të disa muzeumeve si ai i Etërve jezuitë, Vlorajve, tregon për një shpatë bronz të gjetur në Shkodër e që ndodhej në Muzeun Britanik, tregon edhe për figurën e famshme të «Damës antike shqiptare të Gurit të Zi», që kishte përfunduar në muzeun e Luvrit. Gjithashtu Ugolini, në këtë libër, bën një historik të shkurtër të misioneve arkeologjike italiane në Shqipëri gjatë shekujve, që nga Kiriaku i Ankonës. Dhe jo pa qëllim Ugolini do të theksojë primatin italian edhe në arkeologji, duke treguar se janë vetëm italianët ata që kanë ditur të vlerësojnë kulturën e lashtë të këtij populli, duke spekuluar edhe me emrin e një humanisti siç ishte Kiriaku i Ankonës, ashtu siç do të bënte edhe me vetë poetin e madh të lashtësisë, Virgjilin.

Ugolini tregon për një stele me mbishkrim të një luftëtari, me shpatën, mburojën, diskun, dhe që ia kishte treguar inxhinieri i shoqërisë italiane të minierës së bitumit në Selenicë, Inaihen, grabit disa mo-

1) Gazeta zyrtare, e cituar.

2) L. M. Ugolini. «Albania Antica», vol. I, Romë-Milano, MCMXXVII.



numente me dimensione të vogla dhe në mënyrë të veçantë monedha nga Amantia, Orikumi, Apolonia, të cilat i analizon Kesano, përgjegjës i monetacionit të Muzeut Nacional Roman.

«Në fushën e germimit dhe të rikonjucionit arkeologjik në terrenin e Shqipërisë antike nga viti 1924 e më tutje dhe me një vështrim të veçantë në qytetin e Foinikes (1926-1927) dhe të Butrintit (1928-1931) nga misioni arkeologjik italian u grumbulluan një numër monedhash antike të cilat ndodhen në numër të madh të rreshtuara sipas përmbajtjes dhe të përshkruara në një shtojcë në dy vëllime në të cilat dr. Ugolini, kryetar i misionit, jep një përmbledhje të pjesëshme... Duke pasur mundësinë të ekzaminuar në mënyrë të veçantë këtë material numizmatik të depozituar (nënkupto grabitur) në Muzeumin Nacional të Romës, besoj t'i analizoj në bazë të të dhënave të fundit të shkencës arkeologjike.»<sup>1)</sup>

Por Ugolini di të vërë dhe maskën e një filantropi. Në Muzeumin Nacional të Romës ndodheshin disa objekte arkeologjike nga varreza e Kalasë së Dalmaces dhe ato iu kthyen përsëri Shqipërisë (pasi u bë dhe një bujë e madhe në shtyp), për t'u bërë pjesë e koleksionit të Muzeut Kombëtar të Tiranës.<sup>2)</sup>

Kësaj i thonë që hajduti të dhuron një grimë nga ajo që të ka vjedhur (!).

Gjatë viteve 1926-1927, Ugolini kishte gërmuar në Foinike me një qëllim të caktuar haptazi «të zbulonte lidhjet e lashta midis dy brigjeve të Adriatikut» dhe të «provonte se historia ka synuar përherë të krijojë aty një unitet kulturor-politik dhe shtetëror». Pra Ugolini me misionin e vet arkeologjik përpiqej të provonte «historikisht» që gjoja Shqipëria ishte pjesë e pandarë e Italisë: pra përgatiste me «argumente

---

1) S. L. Cesano, «Monetazione e Circolazione sul suolo dell' antica Albania», Romë, 1932, f. 5(47).

2) L. M. Ugolini, «Albania Antica», vol. I, f. 41.

shkencore» dhe nga «ana teorike» agresionin fashist të Shqipërisë që do të bëhej më 7 prill 1939. Pra Ugolini u përket atyre shkencëtarëve të rremë që, me frazat bajate të hierarkëve fashistë për tokë dhe hapësirë jetike, gjente argumente «historike» dhe «arkeologjike».

Por gërmimet arkeologjike treguan të kundërtën. Foinike ishte një qytet që ishte banuar në parahistori dhe se në kohën e pushtimit romak ishte ka-tandisur në një qendër të vogël dhe të parëndësishme. Libri i Luigji Ugolinit ka edhe shumë gabime të rënda profesionale të cilat ky arkeolog fashist, megjithëse specialist (ai ishte ngarkuar me misione arkeologjike në Tuniz, Sardenjë, Zara, kishte marrë pjesë në gërmimet italiane në Kandia të Kretës dhe në ato të ishullit Tinos në Egje etj.), duke i shërbyer një ideologjie të caktuar, për të arritur një objektiv, shtrembëron historinë. Po kështu ai, në kundërshtim me realitetin, zmadhon qëllimisht dhe rëndësinë e monumenteve të ndërtuara gjatë pushtimit romak. Po dielli s'mbulohej dot. Ky qytet i Epirit, me akropolin e vet gjigant, ishte një dëshmi e gjallë e kulturës së lashtë të vendësve dhe Ugolini, me misionin e vet në Foinike, ndien dështimin, prandaj u drejtua të gërmojë në një vend tjetër, në Butrint, duke lënë njëkohësisht në mëshirën e fatit monumentet e posazbuluar të Foinikes.<sup>1)</sup>

Në Butrint, Ugolini i nisi gërmimet e veta në verën e vitit 1928. Për të realizuar atë që s'e arriti dot në Foinike, ai manovron me legjendën e shpikur të Eneas si me një burim historik dhe i kërkon gjurmët e Eneas, «gjyshit» të popullit romak, te një portë e qytetit, te emri i shpikur i kënetës apo lumit.<sup>2)</sup>

---

1) Rezultatet e këtij gërmimi Ugolini i publikoi në «*Albania Antica*», II.

2) Neritan Ceka, «Lashtësia, e vërteta dhe e sotmja», «Drita», 16 shkurt 1975.

Ugolini shkruan:

«Pak vënde ndër të cilat janë bërë gërmime arkeologjike kanë dhënë, në të parat orvajtje eksplorimi, rezultate aq të mira si ato të arritura në Butrint — një lëndë historike e ngjeshur me një mënyrë të shkëlqyer e të këndshme, me një ngjyrë poetike dhe legjendare. Duhet të kthehemi prapa në gërmimet e Trojës, Mikenës, Tirintit, për të gjetur krahasime përkatëse. Dhe me të vërtetë, Butrinti ka me vendet që përmendëm një histori të ngushtë, edhe ai ka të bëjë me epopenë e madhe të lashtësisë: luftën e grekëve kundër trojanëve për rrëmbimin e Elenës, përpjekje që mori fund me prishjen e Trojës. Por ndërsa ngjarjet dhe veprimet historike legjendare, veçanërisht ato të jetës trojane, gjetën për këngëtar të tyre Homerin, Butrinti nga ana e tij dhe ngjarjet që u zhvilluan këtu u treguan prej Virgjilit.

Këndon ky vjershëtor i këndshëm dhe epik i Romës perandorake... si Eneu duke u endur me shumë vuajtje në kaq dete dhe kaq rreziqe e duke pritur që e thëna e perëndisë të plotësohej e të ngrinte në Itali një Trojë të re, arrin në Butrint; këtu me habi të madhe... has trojanin Elen (bir i Priamit), që ishte martuar me Andromakën (të venë e Hektorit) dhe ishte bërë mbret i këtyre viseve... Eleni kishte ngritur në këtë vend një fortesë, e cila në proporcione të vogla i shëmbëllente qytetit të vjetër dhe po me emra trojanë quante kështjellën, portat e qytetit, lumenjtë etj.

Në pallate madhështore me qemere dhe shtylla prej mermeri, Eneu qëndroi dy ditë, duke shijuar shërbimet prej mbreti që i bëjnë, në mes të takimeve të argjendta dhe kupave të arta, dhe dëgjon nga Eleni profecira që ia çelin shpirtin. Pastaj, pasi mori me vete shumë dhurata të vyera, duke falenderuar e duke uruar të ngrejë në Itali një qytet si Butrinti, që t'i përgjigjet Trojës kapërceu Adriatikun.»<sup>1)</sup>

1) «Studenti shqiptar», 1929, nr. 1, f. 9-12; nr. 2, f. 42-47; «Zbulimet e rishta arkeologjike italiane në Shqipëri»

Dhe Ugolini, ky Shliman i vogël, ashtu siç bëri Shlimani në Trojë, shkatërroi në Butrint monumentet e lashta. «Gërmimet e tij janë një gjurmim i çoroditur i monumenteve të kohës romake. Pa mbaruar një gërmim niste tjetrin dhe sipërfaqja e qytetit të lashtë u mbush plot me gropa uji, ku notonin midis ujërave monumente të pasqaruara. Për të krijuar një vilë luksoze, ekspedita italiane që sillej aty si në një tokë pa zot, zhdukuri çitadelen mesjetare, të cilën gjoja e restauroi... Duke mos marrë parasysh faktet arkeologjike dhe vetë mbishkrimet e botuara prej tij, ku Butrinti del si qendër e fisit epirot të Prasaibeve, Ugolini e konsideron qytetin si koloni greke. Këtë e pason një paraqitje e gabuar e mureve rrethues, ku kthesat quhen kulla dhe pjesë të të njëjtit mur datohen në kohë të ndryshme. Duke u përpjekur të tërheqë vëmendjen mbi monumentet e periudhës romake, ai kalon përciptazi ndërtimet shumë të rëndësishme të shekullit 4-3 para epokës sonë, që dëshmonin për zhvillimin e vrullshëm ekonomik dhe kulturor të qytetit para pushtimit romak. Njëlloj si në Foinike, në botim mungonte materiali keramik i zbuluar gjatë gërmimeve, pa të cilin nuk mund të shpjegohet jeta e monumenteve dhe vetë qyteti antik. Kjo për arsye se ky material nuk u mbledh sipas kritereve shkencore, meqë gjithë vëmendja u përqëndrua në zbulimin e mbishkrimeve, skulpturave dhe sendeve artistike (natyrisht me synim për t'i vjedhur...»<sup>1</sup>)

Në faqen jugore të kodrës, Ugolini zbuloi muret rrethues të qytetit, që ishin të fortifikuara me kulla vrojtimi dhe porta, ndërmjet të cilave hyhej brenda në qytet, por edhe për arsye strategjike në rast të ndonjë rrethimi eventual. Ugolini zbuloi një portë të madhe dhe të bukur dhe e quajti porta Skea, duke spekuluar në atë pasazh të Virgjili që i vinte Eneut këto fjalë: «Dhe duke hyrë në portën Skea, pragun e dashur përqafova.»

1) Neritan Ceka, «Lashtësia...», po aty.

Kjo legjendë e shpikur e Ugolinit u trumbetua kudo nga propaganda fashiste italiane. Me emrin e madh të Virgjilit u spekulua në mënyrë të kobshme. Koloneli fashist, poeti Enriko Grasi në një konferencë me nxënësit e gjimnazit të Tiranës (maj 1933) tha:

«Virgjili, Virgjili ynë, poeti më i madh i shekujve e parafoli bashkimin dhe lidhjen tonë. Tokat tona janë të ndara prej detrave, por është një det që na bashkon e na forcon: deti i Eneut, deti i Romës, deti i Venedikut, deti Adriatik, deti shqiptar. Është deti i origjinës sonë mijëvjeçare, deti i profecisë sonë, i fuqisë sonë dhe i shpresës sonë.»<sup>1)</sup>

Kështu në mënyrë të paturpshme i mohojë këtij populli ekzistenca e tij si komb në këtë truall të lash-të, i mohoheshin luftërat e paepura që u kishin bërë ilirët pushtuesve romakë, lihej në harresë Paul Emili që dogji, shkatërroi dhe grabiti 70 qytete, që vrau dhe bëri krime të tmerrshme mbi popullsinë liridashëse ilire. Me një fjalë shtrembërohej në mënyrë bajate historia.

Në grabitjen e vet, Ugolinin e ndihmoi edhe mënyra e stërholluar me të cilën fashistët italianë kishin hartuar aktmarrëveshjen me qeverinë shqiptare në lidhje me gërmimet arkeologjike.

Në pikën e nëntë të kësaj aktmarrëveshjeje, parashikohet që materialet e zbuluara t'i dorëzoheshin qeverisë shqiptare, e cila zotohej t'i mbledhte e t'i ruante në Muzeumin Kombëtar, duke pasur parasysh këshillat dhe dëshirat e misionit arkeologjik italian.<sup>2)</sup> Por agjentët e Italisë fashiste, që vepronin dhe vetë brenda qeverisë shqiptare, arritën ta shkatërrojnë këtë muzeum, duke e shëmbur atë, sepse toka iu shit shoqërisë së sigurimeve, që vuri si kusht të parë shëmbjen e godinës së muzeumit, për të ndërtuar godinën

1) «*Minerva*», nr. 10, 15 maj 1933, f. 6-7.

2) Pika nr. 1 e aktmarrëveshjes.



e vet.<sup>1)</sup> Me këtë rast humbën dhe u grabitën shumë nga munumentet, që ishin sjellë nga Apolonia dhe Durrësi. Një pjesë fare e vogël u vendos në Bibliotekën Kombëtare në gjendje të mjeruar.

«Në të hyrë të Bibliotekës Kombëtare shihen disa trupore të cingueshme, ndonjë kapitël... e ndonjë basoreliev... teprica të Muzeut Shqiptar që pat qënë ngrehë tash pak vjet e mbaroi në kurrqja. Duket qeveria ka lidhje kontraktore me shoqëri të huaja për me gërrye e me kërkue në kondita të damshme për historinë kombëtare sepse të huajve u jepet leja me nxjerrë prej Shqipnije çka ma e mirë gjindet...»<sup>2)</sup>

Kështu që misioni arkeologjik italian meqë nuk kishte një muze kombëtar «ishte i detyruar» t'i mban-te për «ruajtje» të gjitha objektet e zbuluara, po në Butrint. Kjo do të thoshte që të kishte dorë të lirë në grabitje. Dhe Ugolini, si një arkeolog fashist dhe hajdut profesionist që ishte, me anë të motobarkës së ekspeditës, shpuri përtej detit dhjetëra e qindra objekte me vlerë.

Tipik është rasti i grabitjes së kokës së famshme të Deas.

Një nëpunës patriot nga Saranda e diktoi atë në arkat që transportonte në Itali kjo motobarkë. Për të mbyllur një skandal politik, qeveria italiane bëri presion mbi Ahmet Zogun, për të nënshkruar një akt faljeje të kësaj vepre dhe ai e nënshkroi.

Koka e Deas së Butrintit (shekulli 4-3) ishte si pjesë e një shtatoreje (2.5 m. lartësi). Ajo përbëhej nga dy pjesë: Trupi, kopje e mëvonshme, derivat i një prototipi grek të gjysmës së dytë të shekullit të 5 para epokës sonë dhe që i përkiste shkollës së Fidias. Mbi këtë trup u gjet një kokë me bukuri të rrallë, që u mbiquajt «Dea e Butrintit», me vlera të mëdha artistike, si një kryevepër e artit antik, e krijuar nga dora e Proksitilit.

1) «Dituria», 1927, nr. 9-11, f. 351.

2) «Shqipëria e ilustrueme», Shkodër 1929, f. 48.



39. Dea e Butrintit, koka.

Pas Ugolinit gërmimet arkeologjike në Butrint i vazhdoi Pirro Markoni. Edhe ky fashist i orëve të para, që vdiq nga një aksident ajror, vazhdoi t'i bje-



38. Dea e Butrintit.

rë po asaj «këmbane» që i kishte rënë dhe Ugolini:  
«Shqipëria, për afrimin e saj të madh me Italinë,  
ka qenë kurdoherë objekt i kujdesjes së kësaj... Dhe

të parat dhe me të gjerat kërkime shkencore të bëra janë po të italianëve, të cilët u shquan sidomos në sheshin e historisë natyrore, (botanikë, faunë, gjeologji, mineralogji), të literaturës, të gjuhësisë, të historisë, të folklorit etj.»<sup>1)</sup>

Të bie në sy identiteti me atë që kishin bërë austriakët në fillimet e këtij shekulli, duke dërguar një turmë shkencëtarësh, gjoja për të studiuar, por në realitet për të përgatitur pushtimin. Dhe këta arkeologë italianë, që kishin ardhur në Shqipëri, duke i mohuar çdo gjë popullit tonë, vinin në plan të parë «ndihmën» që i kishin dhënë për ta «qytetëruar» sa guxonin të thoshnin se edhe ullinjtë e Shqipërisë ishin mbjellë nga venecianët. Prandaj, thoshin ata, «Shqipëria do të arrijë përparimin e vet vetëm në saje të bashkimit të saj me Italinë». Kjo ishte logjika e agresorit, logjikë që e kishin përdorur dhe pushtues të tjerë, por, në qendresën heroike të këtij populli ata kishin thyer e do të thyenin kokën.

---

1) Pirro Markoni, «Zbulimet e rishta arkeologjike italiane në Shqipëri-Eksploatatimet», Drita, f. 3, 18 prill 1939, nr. 776. Ky arkeolog fashist shkon edhe më tej duke mohuar prejhistorinë, duke e lidhur historinë tonë me «perandorinë e madhe romake», kur dihet që ilirët i bënë një rezistencë të fortë dhe heroike.

## ZBULIMET ARKEOLOGJIKE NGA LEON REJ DHE GRABITJA E TYRE NGA FASHISTËT ITALIANË MË 7 PRILL 1939

Në vitin 1923, para se të bëhej marrëveshja arkeologjike me Italinë fashiste, ishte lidhur një marrëveshje me një mision arkeologjik francez. Atij i ishte dhënë e drejta për të bërë gërmime në prefekturat e Shkodrës, Durrësit dhe Beratit. Misioni financohej nga Akademia e Inskripcioneve dhe e Arteve të Bukura dhe nga shoqëritë franceze të gërmimeve arkeologjike.

Ky mision, pasi bëri disa sondazhe në Durrës, të gjithë veprimtarinë e vet e zhvilloi kryesisht në qytetin e lashtë të Apolonisë, ku bëri zbulime të rëndësishme. Në krye të misionit ishte një njeri përparimtar dhe arkeolog i shquar, Leon Rej. Duke qenë shok dhe mik i Justin Godartit, ai punoi me ndershmëri dhe është një arkeolog i huaj që nuk ka grabitur. Herë mbas here ai mbante konferenca të ndryshme në Shqipëri dhe jashtë saj. Leon Rej mbajti referate në Shkodër, në Tiranë, në Korçë, në Berlin dhe në Drezen, i thirrur nga shoqëritë arkeologjike gjermane dhe në Universitetin e Luvenit (Belgjikë) mbajti një cikël leksionesh të ndryshme dhe njëkohësisht kishte vendosur të krijonte një shoqëri studimesh mbi



historinë e Gjergj Kastriotit, — Skënderbeut, që do të bëhej, sipas tij, «një qendër dokumentacioni dhe bibliografie mbi të gjitha faktet që kishin të bënin me jetën dhe veprën e heroit tonë kombëtar.<sup>1)</sup>

Leon Rej në gjurmimet e veta në Apoloni zbuloi muret rrethuese të qytetit, portikun plot me skulptura të bukura, odeonin, Monumentin e Agonotetëve dhe shumë objekte arkeologjike të rëndësishme.<sup>2)</sup>

Ai dëshironte që me këto objekte të zbuluara të ngrihej një muze në Apoloni, po kjo dëshirë e tij ishte një zë në shkretëtirë. Të gjithë objektet dërgoheshin në bashkinë e atëhershme të Fierit dhe liheshin në një gjendje të vajtueshme.

*«Arkat që përmbanin sendet ishin lënë në një sallë të katit të parë dhe me shumë mundime ishin ngritur dhe mbështetur mbas murit statujat prej mermeri. Kapitete, fragmente arkitektonike, disa relieve, epitafe dhe mbishkrime të ndryshme shtriheshin të përziera mbi tokë. Kryetari i bashkisë kishte ekspozuar mbi një trapezë disa enë dhe objekte të ndryshme prej balte ose prej bronzi. Kudo kishte shumë pluhur dhe pamja e përgjithshme ishte e vajtueshme. Me shtimin e sendeve, çrregullimi shtoej dhe aty nuk kishe ku të hidhje mollën. Ata që shprehnin dëshirën, pranoheshin të vizitonin këtë Capharnaum dhe u mbetej një përshtypje e keqe, që nuk i nderonte aspak autoritetet përgjegjëse. Ndërtimi i një muzeumi që parashikuar prej bashkisë së Fierit... por nga mungesa e të hollave... punimet mbe-*

---

1) «Përpjekja shqiptare», nr. 1-2. 1936, f. 53; nr. 14-15, 1918, f. 145.


2) Leon Rej, rezultatet e gjurmimeve të veta i publikoi në «Albania», revue d'archeologie, d'histoire, d'art et des sciences appliquées en Albani et dans les Balkans, gjithsej 6 numra.



40. Pamje nga Apolonia, viti 1937.

*ten për gjysmë dhe bari filloi të mbulojë ndërtimet e braktisura».<sup>1)</sup>*

1) Leon Rej. «Përpyjekja shqiptare», 1937, nr. 11-12 f. 240-243; Këtë artikull kjo revistë e kishte përkthyer nga «Revue Internationales des Etudes Balkaniques», III, 1937, vëllimi 1(5), f. 301.



41. Pamje nga Apolonia, viti 1939.

Mbas shumë përpjekjesh, u arrit që në tetor të vitit 1936 të ngrihet një muzeum në qytetin e Vlorës, në shtëpinë historike ku patrioti Ismail Qemali, së bashku me Luigj Gurakuqin dhe Isa Boletinin me shokë, kishin ngritur flamurin për Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë.

Muzeumi ishte ndërtuar në këtë mënyrë: në të dy sallat e katit të parë ishin ekspozuar statujat honorifike që zbukuronin stoon e Apolonisë (shekulli II i epokës sonë), kapitalet, mbishkrimet, bazorelievet arkaike (fillimi i shekullit V para epokës sonë). Në sallat e katit të dytë ishin vendosur enët prej balte, monedhat, terrakotat, figurinat prej bronzit dhe antikatat e tjera, të ndara në rend kronologjik dhe të vendosura nëpër vitrina prej xhami. Në këtë muze ishte parashikuar dhe një dhomë në kujtim të ditës së shënuar të pavarësisë dhe për dokumente të



42. Ky fotomontazh me këtë shtatore të zbuluar në Butrint, në sfond të së cilës parakalojnë ushtarët e fashizmit, e bën edhe më të qartë qëllimin e Ugolinis, këtë arkeologu fashist që u përpoq të argumentojë «historikisht» «unitetin e dy brigjeve të Adriatikut», pra të parapërgatiste agresionin e 7 prillit 1939.

tjera mbi topografinë historike të qytetit të Vlorës dhe krahinave përreth.<sup>1)</sup>

1) Leon Rej. «Përpyekja shqiptare», 1937, nr. 11-12 f. 240-243; Këtë artikull kjo revistë e kishte përkthyer nga «Revue Internationales des Etudes Balkaniques», III, 1937, vëllimi 1 (5), f. 301.

Por as ky muzeum nuk pati jetë të gjatë. Më shtatë prill 1939 Italia fashiste pushtoi vendin tonë. Gazetat zëdhënëse të këtij agresioni shkruanin se «zani i heroit (Eneut, H.U.) që mbërrin pas kaq shekujsh dhe mijëra vjetësh i pashuejtun, fitoi forcë dhe vlerë ma të madhe sot që miti asht përfundue e Shqipnia ash bashkue me Italinë. Vërtetohet kështu profecia e madhe e poetit glorioz Virgjil.» Ndërsa në një revistë shkohej aq tej, sa botohej fotomontazh me një skulpturë të zbuluar në Butrint nga misioni arkeologjik italian në sfond të së cilës parakalonin të armatosur ushtarët e Duçes.<sup>1)</sup>

Kështu që në këto ditë të vështira për fatet e kombit tonë, kur gjaku i Mujo Ulqinakut skuq tokën e shenjtë shqiptare, për të gjithë njerëzit u bë edhe më e qartë figura e Luigj Ugolinit, këtij arkeologu fashist dhe prifti shpirtëror të agresionit.

Fashistët hedhin një gjyle në ndërtesën e Muzeumit të Vlorës, pastaj shkojnë që «ta shpëtojnë nga zjarri që ra». S'është për t'u çuditur që i gjithë muzeu u boshatis me një shpejtësi të rrufeshme, duke u grabitur i tëri. Mbeti vetëm ndonjë mermer në katin e poshtëm.

Gazeta franceze «Kandit» shkruante disa kohë më pas:

*«Muzeu Arkeologjik i Vlorës, që përmbante midis të tjerash antikitetet, një koleksion të shkëlqyer vazosh arkaike të ardhura nga gërmimet frënge në Apoloni, mbasi u bombardua nga përfaqësuesi e qytetërimit ësh-të boshatisur prej të mallkuarve.»<sup>2)</sup>*

Arkeologu freng Leon Rej, bëri dhe ai një protestë të cilën e botoi në numrin gjashtë të revistës së tij «Albania». Ky numër meqë u censurua nga fashistët, mundi të hynte në Shqipëri në kopje fare të pakta. Por megjithatë, lajmi i grabitjes së Muzeumit të Vlorës mori dhe

---

1) La Vie d'Italia, Maj 1939, nr. 5.

2) «Candideit», nr. 790, 3 maj 1939.






43. Vazo e grabitur nga Muzeumi i Vlorës prej trupave fashiste të pushtimit.

në, saqë fletoret fashiste u detyruan që ta përgënjeshtrojnë në shtyp këtë «helm», që shpërndante propagandën e huaj.

Mirëpo realiteti s'mbulohej me gjethen e fikut, popullit iu bë e qartë se atij i ishin grabitur monumente me vlerë të kulturës dhe njerëz të ndryshëm patriotë ngri-tën zërin me forcë kundrejt kësaj padrejtësie. Kështu që bashkë me lirinë, popullit po i mohohej dhe historia.

Pushtimi fashist e intensifikoi edhe më shumë gra-bitjen e monumenteve arkeologjike nga Shqipëria. Thu-ajse i gjithë materiali i grumbulluar në Butrint u tran-sportua përtej detit, ndërsa gërmimet arkeologjike ita-liane u shtrinë edhe në Apoloni.



44. Protesta autografe e Leon Rejt, për grabitjen e Muzeut të Vlorës.

Në këto vite humbi dhe statuja e vashës së Vlorës (gur gëlqeror, 0,87 m e lartë). Ajo përfaqësonte një vaj-zë të re me tipare të imta dhe delikate. Këmbën e djath-të e kishte të hedhur prapa dhe duart i takoheshin për-



45. Vasha e Vlorës, pamje anësore.



46. Vasha e Vlorës, pamje përballë.

para. Skulptura ishte pa kokë dhe ndoshta, nga një gropë që i gjendej mes dy supeve, mund të supozoje se ishte punuar në dy pjesë: trupi dhe koka, që ishin pu-

nuar veçan njëra-tjetrës dhe pastaj më vonë, duhej të ishin bashkuar duke krijuar një skulpturë të vetme.

Më shumë se për realizimin artistik kjo statujë kishte rëndësi për veshjen e saj të veçantë. Vajza kishte veshur një këmishë me mëngë të shkurtëra, të ngushta, të hollë, të ngjitur pas trupit. (E ngjashme me veshjen e damës antike shqiptare të Gurit të Zi). Natyrisht kjo dallohej aty ku nuk mbulohej nga dy veshjet e tjera, pra mbi gjoks, mbi supe, në krahun e djathtë.

Mbi këtë këmishë vajza kishte hedhur një veshje që po e quajmë të dytë prej pëlhure të trashë e që vinte duke u mbledhur në pjesën e sipërme. Që nga gjoksi kjo veshje ndahej në pala dyshe, të rregullta, të ngjeshura, që zgjeroheshin duke zbritur poshtë e ku pëlhura qëndronte fare lirisht. Në supet, në bel dhe në buzën e poshtme të veshjes dallohej mirë një rrip i ngushtë.

Pjesa e tretë e veshjes ishte manteli prej stoffe, me dimensione më të vogla dhe i pajisur në buzë me një kordele që dallohej mirë dhe në çdo anë të tij kishte nga një xhufkë. Manteli e mbështillte figurën vetëm pjesërisht, duke i lënë të zbuluar një cep të dorës dhe të krahut të majtë. Pas shpine manteli rrotullohej nga e djathta e në lartësinë e ijeve ishte mbështjellë në pala, duke kaluar përpara i mbajtur nga dora e majtë. Prandaj vajzës gjithë trangu i mbetej i zbuluar (po kështu gjithë supi, krahu i djathtë dhe një pjesë e shpinës.)

Forma e veshjes ishte vërtetë tipike dhe dallohej krejtësisht nga tipet e veshjes klasike dhe ç'është më e rëndësishmja, po në krahinën e Vlorës ishin gjetur statuja të tjera po prej guri gëlqeror të ngjashme me të. Kjo i bëri arkeologët dhe specialistët që të mendonin se kishin të bënin me një veshje tipike të grave ilire.

Italianët grabitën në Shqipëri dhe disa thesare monedhash. Më 30 gusht të vitit 1941 në Durrës, duke u hapur një kanal, u gjendën tri enë balte plot me mone-

dha antike me peshë 13,5 kg; është thesari më i madh i këtij lloji i zbuluar në Shqipëri. Thesari përmbante dhe shumë objekte argjendarie, të cilat u grabitën nga karabinierët fashistë. Ata, për të zhdukur gjurmët, kurdisën me kryepunëtorin italian një deklaratë, ku thuhej se sendet e argjendit i ishin shitur nga zbuluesi i thesarit një ushtaraku në kalim!<sup>1)</sup>

Gjithashtu, një thesar tjetër u gjend në katundin Vrrin, në afërsi të Durrësit. Shoqëria kapitaliste «EIAA» kryente punime ndonjë kilometër larg fshatit. Papritur, aty dolën disa enë të mëdha balte të mbyllura. Drejtuesit fashistë të punimeve, mbasi verifikuan përmbajtjen e tyre. urdhëruan punëtorët shqiptarë të largoheshin nga vendi i gjetjes dhe kërkuan që t'u vinte me urgjencë një miet nga Durrësi. Për përmbajtjen e këtij thesari s'dihet asgjë. Ai u ngarkua me një kamion për në Durrës dhe ndoshta u bë pronë e hierarkëve fashistë të qytetit ose është transportuar fshehtazi për në Itali, si objekte të tjera të panumërta arkeologjike të Shqipërisë.

Një formë e stërholluar e grabitjes së monumenteve arkeologjike ishte dhe pjesëmarrja e Shqipërisë në ekspozitat italiane. Por as kjo nuk ishte origjinale. Pushuesit fashistë përsërisnin mbas dy dekadash po atë që kishin bërë austro-hungarezët gjatë Luftës së Parë Botërore. Shumë objekte që u dërguan në Ekspozitën e Napolit nuk u kthyen më.<sup>2)</sup>

---

1) H. Ceka, «Zbulimi i një thesari monedhash në Durrës», «Buletini i Shkencave Shoqërore». Tiranë 1958. f. 145-147.

2) «Radiorevista», Tiranë, 15 mars 1940, nr. 2. f. 18.

«Pavioni shqiptar në mostrën trevjeçare të Napolit» shkruan: «Është një pavion ku Shqipëria tregohet ashtu siç ka qenë gjatë kohës së historisë së saj më të mirë... në të figurojnë sende arkeologjike... së cilës do t'i japin materiale të shumta dhe plot interes Butrinti dhe Feniqi i afërm që e panë përsëri dritën e diellit nga misioni arkeologjik italian.»





47. Statujë nga Apolonia, grabitur nga pushtuesit fashistë italianë.



48. Shtat i Artemisit, grabitur nga pushtuesit fashistë italianë.



49. E ashtuquajtura «Herkulaneja e madhe», grabitur nga pushtuesit fashistë italianë. Është kthyer pas Çlirimit të vendit vetëm koka.

## POPULLI I KUNDËRSHTON GRABITJET

Populli është krijuesi i madh i thesarit shekullor të monumenteve. Ky është një thesar, por është njëkohësisht edhe kronikë e jetës dhe e talentit madhështor të popullit. Në këtë kuptim, emrat e artistëve, mjeshtërve të talentuar, që kanë gdhendur në mermer, në gur, në dru, në argjend, që kanë lënë mbishkrimet me vlera historike për kohën, janë indentifikuar me masën e popullit nga gjiri i të cilit kanë dalë.

Populli që krijon është njëkohësisht dhe ai që shikon dhe i mbron krijimet e tij. Ai nuk mund të jetë indiferent, ai karakterizohet nga një përkujdesje plot pasion, nga një dashuri e pafund, ndaj veprave të artit në shekuj dhe u del zot atyre.

Grabitja sistematike ka qenë një faktor negativ që i kundërvihet popullit, që mohonte të drejtën e natyreshme të krijimeve të tij, të historisë së tij. Pra, bëhet fjalë për një cungim, për një vjedhje të monumenteve të historisë, të kulturës e të objekteve të tjera që flasin drejtpërdrejt për shpirtin dhe madhësinë e popullit. Është e kuptueshme që populli ynë nuk mund të kishte tjetër pozicion veç atij të kundërvënies ndaj grabitjeve, të mbrojtjes të të drejtave të tij. Nëpër shekuj populli ka manifestuar kurdoherë shpirtin e tij të revoltës ndaj aneksimeve të fshehta ose të drejtpërdrejta nga ana e të huajve, e vlerave të tij kulturore dhe historike. Ende nuk është shkruar historiku i mbrojtjes së monumen-

teve të kulturës nga populli. Por faktet dhe e vërteta dihen. Njerëz të thjeshtë janë bërë shprehësit e revoltës, të ruajtjes së vlerave të mëdha të së kaluarës me një konsekuencë të rrallë, duke kaluar deri në sakrifikim të vetvetes. Pikërisht në këtë fushë kemi shfaqjen e mrekullueshme të ndjenjave patriotike dhe të dinjitetit kombëtar. Na kanë arritur disa emra të këtyre dëshmorëve të monumenteve, por një numër i madh mbetën anonimë dhe heroizmi i tyre i heshtur plotëson më së miri dhe lartëson dhe aktin heroik të atyre që njihen. Në këtë lidhje kuptimplote ne kuptojmë qartë dhe na bëhet më i saktë informacioni dhe imazhi mbi figurat e njerëzve të thjeshtë që do të përmendim më poshtë.

Kamber Myrto Bënja, Abaz Ismail Taushani dhe Behxhet Manastiri, bien nën plumbat e ushtrisë austro-hungareze të pushtimit, sepse ndërhyjnë për mbrojtjen e monumenteve të Apolonisë nga grabitja.<sup>1)</sup>

Kamber Myrto Bënja kishte marrë pjesë edhe në ngritjen e flamurit në Vlorë. Gjesti i tij i lartë, ashtu edhe i shokëve të tij, tregon se ata ishin të ndërgjegjshëm, se duke mbrojtur monumentet, mbronin një çështje të lartë kombëtare, mbronin historinë e të parëve. Nga Kamber Myrto Bënja na ka mbetur dhe një rradhua shenimesh, ku njihesh nga afër me botën shpirtërore të këtij patrioti, me mendimet e tij, kupton qartë ndjenjat e tij të pastra dhe dashurinë e pakufishme që kishte për atdheun.

I ngjashëm është dhe rasti që tregon një plak të tëdhetëvjeçar nga Durrësi:

1) «Dokumente historike për t'i shërbyer historisë kombëtare», viti i I, gusht 1926, f. 139; «Prej Durrësit nëpër Vlonë e në Pojan», «Hylli i Dritës», kallnuer 1922, f. 37-44:

«Me zemër të plásur prej dëshpërimit u solla edhe një herë rrotull kishës dhe manastirit tuj hetue veçse rrenime, shkatërrime, teprica. Me kallzuen se shqiptarët... tuj pa ate dhunë (është fjala për pushtuesit austro-hungarezë, H.U.) kishin kundërshtue më fjalë e me punë... Tre oficerë shqiptarë lanë kryet në këtë kundërshtim kaq të drejtë.»





50. Kamber Myrto Bënja, dëshmor i monumenteve.

*Pranë molit të qytetit ishin grumbulluar gurë mermeri me shkrime dhe figura njerëzish. Anijet që vinin me mallra nga Tarabulluzi, Triesteja, Bari, që të mos ktheheshin bosh, ngarkoheshin me këta gurë mermeri*

me shkrime dhe figura njerëzish. Një herë, një mësues i gjimnazit të qytetit, Salih Nivica, u hangër me fjalë me kapëdanin e anijes e puna shkoi me perdore pisqo-llat». <sup>1)</sup>

Sali Nivica qe dhe një publicist i shquar. Shok dhe mik i Çerçiz Topullit dhe i Muço Qullit (ata u vranë në mënyrë mizore me urdhër të gjeneralit malazez Veshovic, që kishte hyrë në Shkodër me hordhitë e tij pushtuese, më 27 qershor 1915) do të shquhet për dashurinë për tokën amtare, për popullin e vet. S'do të kalojnë as pesë vjet dhe Sali Nivica do të vritet po në Shkodër nga një agjent i imperializmit italian në prag të Kongresit të Lushnjës.

Si njeri i ditur dhe patriot, është e natyrshme që ai do t'i bëjë një mbrojtje të tillë këmbëngulëse pasurive arkeologjike të atdheut, siç është dhe fakti që tregon ky plak fetëdhjetëvjeçar nga Durrësi.

Aktet e mësipërme flasin për qëndrime të papajteshme, për një sfidë të drejtpërdrejtë. Por populli, duke përfshirë dhe njerëzit më të thjeshtë, me intuitën e tij popullore ka ditur të mbrojë monumentet në mënyra të ndryshme, për t'i shpëtuar kështu nga kthetrat që zgjatëshin për t'i rrëmbyer.

Një fshatar nga Apolonia një relief që e kishte në murin e shtëpisë së tij, e mbulon me baltë, pastaj e lye me gëlqere që të mos ia rrëmbejnë ushtarët austro-hungarezë të pushtimit. <sup>2)</sup> Ndërsa një qytetar nga Du-

---

1) Bisedë me Ymer Arapin, plak tetëdhjetëvjeçar nga Durrësi.

2) «Prej Durrësit nëpër Vlonë e në Pojan.» artikulli i cituar:

«Tuj folë e tuj ankue me te zot të asaj shtëpie ku unë kisha ra, ky me diftoi se në këtë shtëpi në fund të shkallëve kishte një basoreliev guri, po qe në kohë të austriakëve e kishte pasë lye me gëlqere... Mbas lutjeve të forta erdh ne e nesërme e për pesë minuta e zbuloi me një thikë atë gur të gdhendur. Ishte një rrasë 50+50 cm. mbi të cilin mund të dukej fort mirë një zonjë me një fëmijë për dore, i cili kishte në anën e djathtë një vegël muzikore në trajtë të një organi.

rrësi, një kokë të bukur mermeri e fsheh në pusin e shtëpisë së vet.<sup>1)</sup>

Interesant është gjithashtu dhe ky rast i një fshatari nga Apolonia, që për një kohë të gjatë kishte punuar me Leon Rejin.

*«Ushtritë italiane të pushtimit (viti 1941) hapnin disa transhe dhe papritmas ndeshin në tri shtatore prej guri gëlqeror. Kishin vendosur t'i transportonin të nesërmen për në Fier me qëllim që t'i dërgonin pastaj jashtë Shqipërisë, në Itali. Por ky fshatar me disa të tjerë, me rrezik jete, natën, i marrin fshehtëzi dhe i groposin në një vend tjetër. Mbas Çlirimit të vendit, këto skulptura ia treguan arkeologëve tanë dhe sot gjenden në Muzeun Arkeologjik të Tiranës.»<sup>2)</sup>*

Faktet që tregojnë për kujdesin e madh të popullit për mbrojtjen dhe ruajtjen e monumenteve të së kaluarës janë të shumta. Kishte ndodhur herë pas here që gjatë punimeve për ndërtime shtëpish, hapje kanalesh dhe rrugësh të reja, apo punime të tokës, të zbuloheshin objekte të ndryshme arkeologjike. Njerëzit që i zbulonin ato, interesoheshin dhe i dërgonin tek organet kompetente, por atë kujdes që tregonin njerëzit e thjeshtë s'e gjeje te njerëzit e qeverisë. Këto objekte përgjithësisht hidheshin në ndonjë skutë ose u shiteshin të huajve. Por kishte dhe njerëz patriotë, si Drejtori i Bibliotekës Kombëtare të atëhershme Sotir Kolea, që herë pas here lajmëronte në shtyp për këto dhurata bujare të njerëzve të thjeshtë të popullit dhe tregonte kujdes për t'i mbrojtur e ruajtur ato.

Por populli është gjithashtu një kronikë e gjallë, i cili në kujtesën e tij shekullore ka ruajtur të fiksuar ngjarje të shumta që bëjnë fjalë për shkatërrimin dhe grabitjen e monumenteve të kulturës dhe të veprave të artit. Populli tregon shumë gojëdhëna dhe legjenda të

---

1) Bisedë me Ymer Arapin.

2) Treguar nga arkeologu Skënder Anamali.

cilat në formën e tyre në dukje të thjeshtë ruajnë fakte të vlefshme të një rëndësie të dorës së parë (sidomos për ato raste kur kronika e shkruar hesht).

Fakti që populli ynë ka trashëguar një mori gojëdhënash dhe legjendash si ajo e ndërtimit të Manastirit të Pojanit me gurët e vjetër të qytetit prej mermeri që gjendej nën dhe, e ustallarëve që kur ndërtonin Manastirin e Ardenicës, u mungonin gurët dhe niseshin për t'i mbledhur në një vend të çuditshëm plot gërmadha të rrëzuara; ajo e kishës së vjetër në breg të Bunës që ishte ndërtuar me gurë të gdhendur ngjyra-ngjyra e që ishin marrë në fshatin Gur i Zi, dikur një vendburim i lashtë, apo gojëdhënat për thesarkërkues dhe vjedhës së monumenteve në zonat e Kalasë së Dalmaces, në Durrës, në Muzhel etj. janë dëshmi tjetër e asaj që populli i ka ndjerë thellë këto shkatërrime, këto grabitje dhe s'i ka shqitur nga kujtesa e tij, por i ka trashëguar brez pas brezi. Ndryshe s'ka si shpjegohen gjithë këto legjenda dhe grabitje që kanë brenda tyre gjak, vrasje, dhimbje dhe nota të thella zemërimi.

Mbledhja, grumbullimi i këtyre legjendave dhe gojëdhënave ka rëndësi, sepse plotësojnë një aspekt tjetër të rëndësishëm, si dokumentacion i shkatërrimit dhe grabitjes së monumenteve.

Rilindasit tanë kanë meritën e madhe se qenë ndër të parët që i demaskuan botërisht ndër shkrimet e tyre synimet e të huajve ndaj pasurive arkeologjike të Shqipërisë dhe konkretizuan idenë e një të ardhmeje të ndritur, ku populli do të dinte t'i zbulonte, t'i sistemonte e t'i ekspozonte më së miri monumentet e tij të arkeologjisë e të kulturës së lashtë. Samiu, kryeideologu i Rilindjes sonë Kombëtare, në veprën e vet «Shqipëria ç'ka qenë, ç'eshtë dhe ç'do të bëhet» shkruan kështu për këtë problem kaq të rëndësishëm:

*«Një music e pergjithshme do të jetë në kryeqytet për gjithë sa gjera të vjetra, shtatuera, fytyra, gurë të shkruar etj, që do të gjenden në Shqipëri... dhe qeveria*

e kësaj musie do të mihij dhe rremonje gjithë vendetë dhe qytetet e vjetër për të kërkuar antikera».<sup>1)</sup>

Samiu nuk u kërkon ndihmë të huajve për këtë qëllim. Ai e di se ata do grabisin dhe mendon që gjërmimet t'i bëjnë njerëzit tanë, që do të punojnë në atë muze që ai mendon se duhet të ngrihet në kryeqytet të Shqipërisë.

Ky mendim i Samiut do të theksohej pas një dekade në Kongresin e Manastirit. Përveç qëllimit të madh të atij kongresi historik siç ishte caktimi i alfabetit të përbashkët të gjuhës shqipe, aty do të flitej edhe për nevojën e domosdoshme të mbrojtjes urgjente dhe të shpalljes si të paprekshme të monumenteve të katër vilajeteve.<sup>2)</sup>

Një figurë e lartë, simbolike do të mbetet në historikun e mbrojtjes së monumenteve patrioti dhe dijetari Shtjefen Gjeçovi. Ky është një pionier i arkeologjisë shqiptare, ndër të parët që bëri me kompetencë gjërmime arkeologjike, studiues, propagandues i pasionuar për kulturën e lashtë shqiptare. Gjeçovi nuk nisej nga konsiderata kurioziteti ose thjesht nga një ndjenjë ekzotike, por me ndërjegje ai e konsideronte disiplinën e arkeologjisë si një faktor të lidhur ngushtë me patriotizmin, si një armë kundër mendimeve pseudoshkencore dhe armiqësore të disa dijetarëve të huaj që synonin zhvleftësimin dhe mohimin e kontributit kulturor të Shqipërisë, kulturës së lashtë autoktone të saj. Artikujt e Gjeçovit për arkeologjinë janë plot patos e dashuri për kulturën amtare dhe plot revoltë për ata që kanë grabitur monumentet.


---

1) «Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhetë», botim i gjashtë, Tiranë, f. 78.

2) M. Domi, «Kongresi i Manastirit», Studime Historike nr. 4, Tiranë 1968, f. 170-171.

Në pikën katër të këtij kongresi të riprodhuar nga konsulli austro-hungarez i Manastirit shkruhet: Të gjithë objektet e vjetra që do të gjinden në katër vilajetet e Manastirit, Janinës, Kosovës dhe Shkodrës duhet të mbildhen në një muze në një qytet të Shqipërisë.»





51. Shtjefen Gjeçovi, arkeolog dhe etnograf i shquar, mbrojtës i zjarrtë i monumenteve të kulturës shqiptare.

*«Visari jonë, historia jonë gjinden të mbulueme nën dhe kushedin sa pash e pllambë... Mjafton një kuletë e mbushun me sende të vjetra të gjetuna në tokën tonë*

prej nji të huaji, për të na e lanë në terr një pikë historie... Tash njëzet vjet e këndej... sa njerëz të veçëm kanë pasë vallue Shqipninë, jo për tjetër, por me ja hekun duersh ndonji send të vjetër... e të forcuem me iradë të sulltanëve të Turkisë, për me çilë varre të vjetra a suka (tumuli), tuj na ba dy dame me nji shteg; tuj na marrun neper kambë eshtnat e të parëve e tuj na vorfnue prej sendesh qi gjindeshin të mbulueme bashkë me eshtnat e tyne»<sup>1)</sup>

Shtjefen Gjeçovi bëhej kështu një zëdhënës i popullit të vet për të mbrojtur trashëgimin kulturor të së kaluarës. Duke qenë njëkohësisht edhe specialist, ai e kuptonte më mirë se kushdo tjetër ç'do të thoshte kjo grabitje e pasurive arkeologjike nga të huajt. Ai tregon me dhimbje në zemër për këtë mjerim të kombit të vet:

«Sa rrënime faltroresh të vjetra janë dërmue prej të huajsh, sa vorre, suka dhe qytete janë çilë dhe shpërndarë qi sot s'u dihet ma një fije; sa suka (tumuli) 3000-4000 vjeçare janë rrafshue; sa rrasa, shtylla e kapitale e kso tjerash që kanë ndejte në gjume ta ambel deri parvjet, e sot s'i gjen ma aty... Të shkojmë me pa atë Pojanen (Apolonien) aq të permendur, rrënimet e së cilës patën binde botën dikur... visare të vjetra të saj janë bajtë ndër vende të huaja me qerre e vagona. Të ngjitemi nga Durrësi, nga Tirana e Kruja nga Lezha e Shkodra, nga Kopluku e Vuksan-Lekal, nga Komani e Dushmani e do të shohim prej gropash sa e sa visare janë nxjerrë e bajtë prej të huajsh...»

E zani i tij ushton:

«Mjaft na asht gjymtue historia prej të huajsh, mjaft na kanë nxjerrë e bajtë visare të dheut tonë».<sup>2)</sup>

Edhe patriotë të tjerë ishin ngritur kundër këtij shpërdorimi kulturor. Është kjo arsyeja që disa objekte

---

1) At Shtjefen Gjeçov. «Një argtim arkeologjik», Zani i Shna Ndout, 1920. f. 109-112, 157-158, 182-184, 207-208, 231-232.

2) Po aty.

të zbuluara në qytetin e Durrësit, gjatë punimeve të vitit 1930, për çeljen e kanaleve të rinj të qytetit, u depozi-tuan në depon bashkiake të atjeshme. Pikërisht aty kanë qenë dhe mbishkrimet që përshkruan Adrian Bruhl në «Albanian» e Leon Rejit. Po aty u vendosën edhe materi-ale arkeologjike të zbuluara në Durrës dhe që gjatë kohës së pushtimit fashist u grabitën.

Është kritikë e ashpër që bënin patriotët tanë që e detyroi qeverinë e atëhershme të Ahmet Zogut të deklaronte herë pas here për ngritjen e një muzeumi kombëtar, por në realitet këto mbeteshin në letër. Vetëm mbas Çlirimit, nën udhëheqjen e Partisë, ashtu si në të gjitha fushat e tjera, edhe në arkeologji janë arritur realizime të mahnitshme. Vlerat kuturore të popullit tonë ruhen me ligj, studiohen, restaurohen dhe rezultatet e studimeve pasurojnë historinë e shkruar.

Sot monumentet e kulturës sonë «kanë jetë të gjallë», nuk janë vlera të vdekura antikuari, ose thjesht muzeale, por masat e popullit mësojnë prej tyre historinë madhështore të kulturës sonë në të kaluarën, rrugën e popullit shqiptar në shekuj, duke rritur kështu edhe më shumë besimin për të sotmen dhe të ardhmen akoma më të ndritur të Shqipërisë.

Në një kuptim të përgjithshëm, libri që i paraqitëm lexuesit është një libër i hapur. Studimet dhe hulumtimet e ardhshme, pa dyshim, do të shtojnë e pasurojnë lëndën e subjektit e këtij libri. Vlen të nënvizohet një fakt: ne kemi shënuar pak a shumë rastet e grabitjes së monumenteve që janë pohuar nga vetë autorët e këtyre grabitjeve, në shënimet dhe studimet e botuara prej tyre. Kështu, dashur pa dashur, ata kanë realizuar një vetëdemaskim të kësaj veprimtarie, që vazhdoi për dekada të tëra nga të huajt ndaj popullit tonë.

Libri paraqet, po të shprehemi në mënyrë figurative, vetëm pjesën e sipërme të ajsbergut. Pjesa e nenujshme e këtij ajsbergu, që është sigurisht shumë më e madhe, ka mbetur në anonimatin e ngjarjeve, të heshtjes dhe të prapaskenave, që kanë përbërë praktikën e zakonshme të grabitësve të monumenteve. Sa e sa objekte me vlera të pallogaritshme arkeologjike, artistike e kulturore, janë përvetësuar në fshehtësi, janë rrëmbyer me lakmi, janë degdisur larg trojeve tona, duke u mbë-tjellë përgjithmonë me një mister, me një mungesë të padepërtueshme informacioni për ekzistencën dhe vlerat e tyre. Ky është aspekti më kriminal i veprimtarisë së grabitësve të thësarkërkuesve dhe arkeologëve profesionistë, që kanë dëmtuar e në fakt kanë zhdukur objekte me vlera burimore, objekte që do të sillnin shumë të dhëna të çmueshme për historinë dhe kulturën shqiptare në shekuj. Pra, kemi një masakrim dhe një zhdukje të ndër-gjegjshme të fragmenteve të historisë dhe të kulturës sonë.

Objektet arkeologjike të grabitura, të cilat kanë origjinën dhe nismën e tyre si dhe çertifikatën e autorësisë në Shqipëri, sot ndodhen në muzetë e shteteve të ndryshme, në kontinente të ndryshme dhe kjo shtrirje përfshin një gjeografi të tërë. Kështu gjenden në muzetë, ndër më të mëdhatë e botës, si për shembull në Muzeun Nacional të Romës, Muzeun e Termave në Romë, në Luvër, në Muzeun Sen-Zhermen, në Muzeun Britanik, në muzetë e Berlinit, Vjenës, Stambollit, Beogradit, Nju-Jorkut etj. fragmente dhe objekte të arkeologjisë shqiptare. Këtu nuk po llogaritim objektet e koleksioneve pak e aspak të njohura private të të huajve që janë në një numër shumë të madh.

Tërë vlerat arkeologjike që ekzistojnë dhe që janë ekspozuar, për të cilat kemi shënime apo dhe studime dhe që përbëjnë në vetvete një muze me diciturën: «**Objekte arkeologjike të grabitura nga Shqipëria**», është e nevojshme që të jenë patjetër objekt i interesimit dhe i studimeve tona, si një gjymtyrë e tërë e studimeve për

zbulimet arkeologjike që bëhen sot në Shqipëri dhe që jetojnë një epokë të re, epokën kur grabitjes së monumenteve u është vënë kryq një herë e përgjithmonë, nga shteti ynë socialist, nga Partia jonë.

Kërkimi dhe studimi i objekteve arkeologjike që sot nuk ndodhen në atdheun tonë, ka vlerë jo vetëm për historinë dhe kulturën e Shqipërisë, por edhe në kuadrin e historisë ballkanike dhe evropiane. Ato kanë vlerë të veçantë për sqarimin e problemeve të etnogjenezës, autoktonisë dhe kulturës kombëtare të popullit tonë në shekuj. Fjala vjen, figurina prej bronzi që paraqet një grua në vallëzim, me një veshje etnografike që lidhet me tipin kombëtar të xhubletës shqiptare (kjo figurinë ndodhet në Muzeun Britanik), Stela e Parmeniskut (Vjenë, muzeu historik i artit) që ka karakter unik, të ndryshëm nga modelet greke dhe romake, figurina prej bronzi e «Damës antike shqiptare» (Luver), që gjithashtu është unikal, «Vasha e Vlorës» (e humbur gjatë pushtimit fashist), etj., etj. dëshmojnë për kontributin origjinal të popullit tonë në thesarin e kulturës së njerëzimit.

Shpesh, në botimet e huaja është theksuar se kjo grabitje e pasurive arkeologjike është bërë në një kohë të turbullt, plot vështirësi dhe peripeci të mëdha, në një kohë luftërash dhe trazimesh të forta. Grumbullimi, transportimi i tyre jashtë Shqipërisë dhe vendosja në muzetë e botës, ka qenë «shpëtimtare». Kjo është edhe arsyeja që këta arkeologë dhe përfaqësues të ndryshëm konsullorë e kanë pohuar me gojën e tyre këtë grabitje, por asnjëherë realisht dhe saktë, duke luajtur kështu rolin e Mesisë së monumenteve historike shqiptare.

Kur qenka kështu, këto monumente «fatmëdha» që shpëtuan sepse u vendosën nëpër muzetë e botës, tanimë që Shqipëria është e lirë dhe e pavarur, është një shtet i fuqishëm socialist dhe me plot dinjitet, atëherë përse nuk kthehen përsëri në tokën mëmë?

Jo, realiteti është krejt ndryshe. Arsyeja e vërtetë e kësaj grabitje të pasurive arkeologjike të Shqipërisë

është pjesë e pandarë e prapaskenave që fuqitë e ndryshme imperialiste i kanë thurur vendit tonë gjatë shekujve, veçanërisht që nga koha e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe më vonë.

Grabitja e monumenteve do të thoshte grabitje e vlerave historike, errësimi i kulturës së lashtë të popullit tonë, do të thoshte që Shqipëria të kthehej në një «**Terra Bianca**», për të cilën s'kanë munguar thëniet e arkeologëve të huaj.

Por ndodhi e kundërta. Shqipëria e vogël, ky vend i begatë e i banuar që në parahistori, me gjithë këto grabitje monstruoze, ka ruajtur në brendësi të tokës së saj qindra e qindra monumente me vlerë, themele ndërtesash të zbukuruara me mermere dhe mozaike, rrugë dhe kanalizime qytetesh, gjurmë ujësjellësish dhe vepërash të ndryshme arti, ndërsa mbi tokë kudo syri të zë rrënoja kështjellash, dëshmitare të luftërave të papërra për liri.

Arkeologët tanë kanë zbuluar e zbulojnë vazhdimisht monumente të reja me vlera të mëdha artistike dhe arkitektonike, që e tregojnë popullin tonë kurdoherë një popull me kulturë të lartë dhe me shije artistike.



## KRONOLOGJI

- 1418 — Eksplorimi i parë arkeologjik i Shqipërisë nga Kiriaku i Ankonës.
- 1435 — Eksplorimi i dytë arkeologjik i Shqipërisë po nga Kiriaku i Ankonës.
- 1798 — Ibrahim pasha i Beratit tërheq nga gjermadhat e Apolonisë 70 qerre të ngarkuara me gurë të skulptur, për të ndërtuar sarajet e veta.
- 1806 — Apolonia vizitohet nga Pukëvil. Pak më vonë atje shkon dhe Uliam Martin Lik.
- 1859 — Goltier de Klabri dërgon në Luvër një Tors të Praksitelit të një satiri të gjetur në Apoloni. Kohë më parë Andre Grase kishte hequr nga muret e Manastirit të Pojanit një statujë të Vitories.
- 1861 — Në Shqipëri vjen arkeologu frëng Leon Hëzej, që dërgon në Luvër relieve, mbishkrime e skulptura nga Apolonia e Durrësi. I shpëtuan grabitjes objektet arkeologjike që ishin vendosur nëpër muret e Manastirit të Pojanit dhe Kalasë së Durrësit.
- 1872 — Dumond boton një artikull për një figurinë bronzi të gjetur në Gur të Zi të Shkodrës dhe e quan «Një damë antike shqiptare». Kjo figurinë tashmë ndodhet në Luvër.
- 1880 — Artur Evans grabit një thesar monedhash, që i kishte gjetur në katundin Selcë të Shkodrës. Po Evans në këtë vit grabit një shpatë bronzi nga Shkodra, një figurinë bronzi të një gruaje që vallzon dhe mjaft objekte të tjera arkeologjike.

- 1894 — Në afërsi të Durrësit zbulohen 50 copë drahme argjendi e dërgohen në Muzeumin e Vjenës.
- 1899 — Dëgran gërmon në varrezën e Kalasë së Dalmaces dhe objektet e zbuluara prej tij ia dërgon Muzeut Sen-Zhermen të Parisit.
- 1899 — Treger gërmon në Kalanë e Dalmaces. Gërmimet i vazhdon edhe në vitin 1900 dhe objektet e zbuluara prej tij, i dërgon në Muzeun Arkeologjik të Berlinit.
- 1902 — Në Vrap të Peqinit zbulohet një thesar mesjetar. Objekte të tij shpërndahen në muzetë e Stambollit, Parisit dhe Nju-Jorkut.
- 1909 — Zbulohet sarkofagu i famshëm i Dyrrahut. Ai dërgohet në Muzeumin Arkeologjik të Stambollit dhe për nga vlera artistike është vendosur përkrah sarkofagut të Aleksandrit të Maqedonisë të punuar nga skulptorët e antikitetit Lisëp dhe Leohar.
- 1912 — Serbët pushtojnë qytetin e Durrësit dhe tërhiqen të mundur më 19 maj 1913. Gjatë kësaj kohe ata dërguan në Muzeumin Nacional të Beogradit mbishkrime dhe relieve nga Durrësi.
- 1913 — Malazezët grabisin Muzeumin e Bushatllinjve në Kalanë Rozafat. Armë të Bushatllinjve tashmë ndodhen në Muzeumin Etnografik të Sarajevës. Malazezët grabitën dhe shumë objekte të lasha, enë bronzi e balte të pjekur, fragmente arkitektonike të zbuluara në Drisht.
- 1916 — Akademia e Shkencave e Vjenës në bashkëpunim me institute të tjera të interesuara dhe me komandën e trupave austro-hungareze, që kishin pushtuar pjesën veriore të Shqipërisë deri në Vjosë, organizoi një ekspeditë të gjerë informative, që kishte për qëllim gjurmimin arkeologjik të zonës shqiptare të pushtuar prej tyre dhe dërgimin e këtyre vlerave në Vjenë. Për këtë qëllim erdhën dhe arkeologët Prashniker dhe Shober. Pasuritë e mahnitshme të

- Apolonisë në thesare antike që rrezatonin në krejt rrethet e afërme dhe të largme të qytetit nuk e lanë të qetë Prashnikerin, që erdhi për herë të dytë dhe i vazhdoi kërkimet e tij nga fundi i nëntorit 1917 deri në vjeshtën e vitit 1918, kur ushtria austro-hungareze u detyrua të tërhiqet. Shumë objekte që ai i grumbulloi në Lushnjë dhe në Durrës, për t'i transportuar në Austri, humbën në këto vite të turbullta.
- 1919 — Në breg të lumit Drin në afërsi të qytetit të Lezhës u gjendën 100 drahme argjendi të qyteteve Durrës dhe Apoloni. Vetëm një pjesë e vogël e këtij koleksioni ndodhet në Shqipëri. Pjesa më e madhe është grabitur nga italianët gjatë pushtimit fashist të Shqipërisë.
- 1924 — Vjen për herë të parë në Shqipëri arkeologu italian Luixhi Ugolini. Ai gërmon në Foiniçe dhe në Butrint duke grabitur mjaft objekte me vlera të veçanta. Pas tij i vazhdoi gërmimet Pirro Markoni.
- 1927 — Qeveria e Ahmet Zogut, në vazhdim të masave skllavëruese me fashizmin italian, lidh marrëveshje arkeologjike ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë. Në vitin 1923 ishte lidhur gjithashtu një marrëveshje me një mision arkeologjik francez.
- 1939 — Shqipëria pushtohet nga fashizmi italian. Më tetë prill ushtritë italiane grabitën Muzeumin Arkeologjik të Vlorës. Për këtë grabitje proteston arkeologu francez Leon Rej.
- 1940 — Hapet ekspozita e Napolit. Pavioni shqiptar përmbante dhe shumë objekte arkeologjike nga krahinat e ndryshme, të cilat s'janë kthyer akoma, përveç kokës së Herkulanes së Madhe (trupit i saj s'është gjendur...) e disa skulpturave të tjera me vlera mesatare.
- 1941 — Zbulohet dhe grabitet një thesar monedhash nga Durrësi. Një thesar tjetër grabitet në fshatin Vrrin në afërsi të Durrësit.

## LISTË E OBJEKTEVE KRYESORE TË GRABITURA TË PËRMENDURA NË LIBËR E TË SHPËRNDARA SIPAS MUZEUMEVE

### Muzeu i Luvrit:

#### 1. *Tors i Bakut femijë, mermer, Apoloni.*

Është një kryevepër, dalë nga dora e skulptorit të madh të lashtësisë, Praksitelit. Është hequr nga muret e manastirit të Pojanit, në vitin 1859 dhe është dërguar në Luvër nga M. Goltier de Klabri. Qëndron në sallën Tibre, nr. 665. «Mission...», f. 395; «Das Sand. Berat...», f. 154; Leon Rey, «Albania...», 1, f. 11, shënim 9.

#### 2. *Fragment i një statuje të Vitories, mermer, Apoloni.*

Kjo është dërguar në Luvër disa kohë më parë se Trosi i Praksitelit nga A. Grase, konsulli i Francës në Korfuz. «Mission...», f. 395; Leon Rey. «Albania...». 1. f. 11, shënim 9.

#### 3. *Mbishkrimi i ujësjellësit të Durrësit, mermer.*

Mbishkrimi tregon për riparimin e ujësjellësit të Durrësit në kohën e Aleksandër Severit së bashku me rrugën në një gjatësi prej katër mijë hapash, që ishte dëm-

tuar nga përrrenjtë. Ujësjellësi ishte ndërtuar gjatë sundimit të perandorit Adrian. «Mission...», f. 387, nr. 172; «Rev. Arche». VI, 1862, f. 318; «Alb Stud.», f. 119, etj. Ndodhet në fondet e muzeumit të Luvrit.

4. *Dy figura në altoreliev të Demetres dhe Kores, gur. Durrës.*

«Mission...», f. 378, 460, tab. 27, fig. 2; f. 377, 460; tab. 27; fig. 3. Leon Rey, «Albania...», 4, f. 102. Në inventarin e muzeut figurojnë me numrat 2291 dhe 2292, Për mbishkrimin shih dhe «Rev. Arch.» VI, 1862, f. 321.

5. *Kokë kau me kurorë dhe lule, fragment frizi, Durrës.*

Hëzej e mori pranë xhamisë te Porta e Madhe e qytetit. «Mission...», f. 382, 383, tabela 27, fig. 4; «Cat. Somm». nr. 1427, f. 82; Po aty, botim i vitit 1918, nr. 1427, f. 88; Leon Rey. «Albania...», 4, f. 103.

6. *Kokë e Demetres, mermer, Apoloni, madhësi natyrore.*

Dallohet për linjat e holla, ëmbëlsinë dhe psikologjinë. Pjesa e sipërme e kokës pak e thyer. «Mission...», f. 460, tabela 32.

7. *Antifeks, kërcimtare me palmete, Apoloni.*

«Mission...», f. 460.

8. *Stelë e kalorësit, Apoloni.*

«Mission...», f. 400, 460. Kalorësi është i veshur me klamys dhe në të djathtë të tij ka një shtizë të gjatë. Ndodhet në sallën greke, nr. 837, «Das. San. Berat...», f. 174.

9. *Kapitel i vogël jonik, mermer, Apoloni.*

«Mission...», f. 388, 460.

10. *Kapitel i vogël dorik, gur, Apoloni.*

«Mission...», f. 398-460.

11. *Maskë luani, mermer, Apoloni.*

«Mission...», f. 398; «Das san. Berat...», f. 190; Leon, Rey, «Albania...», 1, f. 24, shënim 54.

12. *Kokë gruaje, mermer, Apoloni, madhësi natyrore.*  
«Mission...», f. 395-396.
13. *Friz me figura të vogla që paraqesin luftë ama-  
zonash, Apoloni.*  
«Mission...», f. 398.
14. *Figurinë gruaje, bronz, Apoloni, dimesione të  
vogla.*

Gjetur në janar të vitit 1881, ndodhet në sallën e bronzit, nr. 2855. Leon Rey, «Albania...», 3, f. 35. Rej boton fotografinë e saj, fig. 31.

15. *Dama antike shqiptare, Gur i Zi, bronz.*

Lartësia 0,28, koka 0,038 m. shekulli VI-V para epokës sonë. Leon Rey, «Albania...», 3, f. 56. Ai tregon se kjo skulpturë arkaike është botuar nga Dymond në «Rev. Arch. Nouvelle», XXIV, 1872 me tre vizatime nga M. Chaplain, idem planshe XV. Këtë artikull me disa modifikime dhe shënime Dymond e botoi në «Melanges d'Arch...», 1892, f. 42-44, planshe XI, me një riprodhim me shumë precedencë; «Repertoire...», II, nr. 7, f. 422 dhe 423, 552, në dy kataloge të bronzëve me dy ilustrime dhe një fotografi nga Ugolini, «Albania Antica», 1, f. 15, fig. 14 etj.

## Muzeu Sen - Zhermen, Paris:

16. *Objekte nga varreza e Kalasë së Dalmaces:*

14 rrathë të mëdhenj qafe, bronz, 400 rruaza, 8 byzylykë, 38 vathë e rrathë vathësh, argjend dhe bronz, 6 zbu-  
kurime vathësh, argjend, 27 zbukurime, bronz, 10 unaza,  
bronz, një unazë, argjend, 17 fibula, bronz, një broshe e  
rrumbullakët, 2 sopata hekuri, një shpatë hekuri, 16 thika,  
maja heshtash, fibula, unaza, hekur.



«Souvenirs...», f. 262; Sollomon Reinach, «Une necropole...» në «L'Antropologie...», 1901, f. 662-670., thotë se në muzeun Sen-Zhermen ndodhen gjithsej 89 objekte me numër inventari 53842-53930, kurse në të vërtetë lista që e paraqet vetë Dëgrani është shumë më e madhe. Leon Rey, «Albania...» 3, f. 52. Ndërsa në Muzeumin Antropologjik të Parisit ndodhen dhe dy kafka nga kjo varrezë.

## Muzeu Arkeologjik i Berlinit:

17. Dy fibula, bronz, një aplike, bronz, një byzylyk, bronz, dy rrathë dore, bronz, një fragment spiraleje, bronz, një fibul hekuri, një latushe hekuri, 23 rruaza qelqi të tipeve të ndryshme, një qafore, bronz, me varëse në trajtë trapezi të ngushtuar dhe në pjesën e poshtme në trajtë ylli, një pafte e veçuar e këtij tipi vathi, një thikë hekuri. Të gjitha objekte nga varreza e Kalasë së Dalmaces.

Traeger, «Mitteilungen...» f. 43-51; Traeger, «Begrabniss...», f. 43-47.

## Muzeu historik i artit, Vjenë:

### 18. *Stela e Parmeniskut.*

Në relief paraqitet një skenë me një betejë amazonash. Ajo ka edhe shenja të tjera të veçanta që e bëjnë të dallohet menjëherë si e artit apolonian. Ashtu si edhe tek stela e Falakres dallojmë pëllumbat duke pirë ujë, një enë të madhe, dy luanë që shqyejnë një dre. Steleja ka formën e një ndërtese, në mes të kolonave dallohet një kurorë lisi, dy trandafilë; elemente të tjera të saj janë sirenat me krahë, grifonet.

«B.Y.SH.T.» 4, 1958, f. 213, 243.

19. *Portret gruaje, mermer, nga Durrësi.*

Skulptori ka ditur të evidentojë me mjeshtëri buzët e holla, ballin e tendosur, vetullat e harkuara, hundën e drejtë, që i japin portretit një shprehje të bukur. Gruaja është e menduar. Ky portret është marrë në vitet e Luftës së Parë Botërore nga arkeologët Prashniker dhe Shober:

«Ylli», 8, 1977, f. 35.

## Muzeu Nacional i Beogradit:

20. *Kokë djaloshi, mermer i bardhë, Durrës.*

Lartësia 0,24 m, sipër në krye i mungon një tufë flokësh. Qepallat, hunda goja janë të dëmtuara. Koka është përkulur disi nga e djathta. Fytyra është punuar mjaft hollë. Me anën e cepit të buzës së rënë si dhe vetullave të fryra dhe të syve të vendosur pjerrët jepet një shprehje habie. «Archeologische forschungen...», f. 43, fig. 52, a, b. Balduin Sara, «Jareschefte...», f. 240-246 njofton se në vitin 1926 kjo kokë është zhdukur për fat të keq. Leon Rey. «Albania...», 4, f. 100.

21. *Maskë komike prej guri të verdhë, Durrës*

Lartësia 0,40 m, gjerësia 0,30. Në të shihen shenja llaçi. Pranë gojës dhe në faqe dallohen gjurma ngjyrash të kuqe dhe të verdhë. Tipi i hundës së gjerë dhe të zgjatur me një gojë të zgjeruar të bën të mendosh se i përkiste komedisë nautike. Katër të përdredhura të mjekrës të stilizuara janë kthyer në të njëjtën mënyrë në relievin e komedisë së Napolit në maskën e Meneandrit në relievin berlinez nga Akuilea. «Archeologische forschungen...», f. 43, fig. 53.

22. *Dy relieve gladiatorësh ose luftëtarësh dalmatë.*

«Mission...», f. 383, tabela 30; «Souvenirs...» f. 180,

foto po në f. 180; «Archeologische forschungen...», f. 44, fig. 54-55, etj.

Këtu jepen dhe përmasat e tyre. Gladiatori i parë: 1,28 lartësia, 0,62 gjerësia, 0,25 trashësia. Gladiatori i dytë: 1,07 lartësia, 0,59 gjerësia, 0,24 trashësia.

23. *Stele me mbishkrim, gur gëlqeror, Durrës.*

Lartësia 0,78, gjerësia 0,43, trashësia 0,14. Steleja ka formën e një porte me dy doreza në formë rrethi. Mbishkrimi ndodhet sipër. Një stelë e ngjashme me të është zbuluar përsëri kohët e fundit në qytetin e Durrësit.

«Archeologische forschungen...», f. 44-45, figurë 56.

24. *Fragment sarkofagu me mbishkrim dhe anije, gur, Durrës.*

Kjo stele ka rëndësi sepse jep pamjen e një anije të lashtë të ancoruar në port me vel dhe njëkohësisht dhe rrema. Veli ka formën e një table shahu. Meqë fragmenti është i thyer duket vetëm pjesa e përparme e anijes. «Archeologische forschungen...», f. 45, fig. 57, 57a (vizatim).

25. *Altar me mbishkrim, mermer, Durrës.*

Lartësia 1,34, gjerësia 0,64, trashësia 0,60. Fusha e mbishkrimit është e rrethuar me dekoracione, ornamente dhe ndërmjet tyre ka të gdhendura gjethe akanthi. Mbishkrimin e këtij altari e kopjon për herë të parë Kiriaku i Ankonës.» «C.I.L.» III, 616, i cili jep vendndodhjen: Durrës, porta lindore e kalasë, nga Balduin Sara, «Antiken...» f. 240-246, viz. 39, Hequard, «Histoire...», f. 265, etj.

26. *Pllakë mermeri e bardhë me mbishkrim, Durrës.*  
Balduin Sara, «Antiken»... f. 240-246, viz. 41.

27. *Reliev i Panit me tri nimfat, gur gëlqeror. Durrës.*

Lartësia 0,47, gjerësia 0,42, trashësia 0,14. Relievi është i dëmtuar në anën e djathtë. Gjithashtu edhe pjesa e sipërme është mjaft e ngrënë. Në reliev duken gjurmë gëlqereje. Nga e majta është dëmtuar gjithashtu gjysma e

poshtme e figurës së Panit. Gëzofit të tij i ka mbetur vetëm një pjesë. Për tek ai me hap vallëzimi vijnë dy nimfa të kapura dorë për dorë. Midis Panit dhe nimfës së parë ndodhet e gdhendur një enë, ndërsa midis dy këmbëve të nimfës një send i pacaktuar. Koka e nimfës së parë mungon, ndërsa të dytës është dëmtuar rëndë, por ajo duhet të ketë pasur një zbukurim koke. Sipas lëvizjes së dorës së nimfës së dytë dhe përfytyrimeve analoge (Pani me tri nimfat, kult i përhapur gjerësisht në Durrës) duhet të ketë qenë dhe një nimfë e tretë. Balduin Sara, «Antiken»..., f. 240-246, fig. 40, Leon Rey, «Albania...», 4, f. 102.

### Muzeu Britanik:

28. *Shpatë bronzi nga Shkodra.*

Gjatësia 48 cm.

«Walters, Catalogue...» numri 2754; Ugolini, «Albania Antica» 1, f. 15, fig. 14; Leon Rey, «Albania...», 3, f. 48.

29. *Figurinë bronzi nga Shqipëria Veriore.*

Është botuar në një kartolinë të nxjerrë nga Muzeu Britanik. Prapa ka të shkruar: Spartania ose vajza që vrapon, fondi nga Shqipëria nr. 208, viti 1976.

30. *Diana, bronzinë nga Shqipëria.*

«Drini», nr. 4., 1 prill 1942, f. 19.

### Muzeu Arkeologjik i Stambollit:

31. *Kokë femre nga Apolonia.*

G. Mendel. «Catalogue...», II, nr. 330, f. 88. Leon Rey, «Albania...», 1, f. 24, shënim 55.

32. *Sarkofagu i Dyrrahut.*

G. Mendel, «Catalogue...», II, nr. 4, faqe 5 – 12; Macridy Bey, «Jarbuh...» faqe 143, nr. 1; «Drini», nr. 4; prill 1942, f. 9.

33. *Fragment sarkofagu, Durrës.*

G. Mendel, «Catalogue...», I, f. 12-14, Leon Rey, «Albania...»; 4, f. 104.

## Muzeu i Termave, Romë

34. *Koka e Deas së Butrintit, mermer.*

Luixhi Ugolini, duke u nisur nga vlerat e saj të mëdha artistike, si një kryevepër e artit antik, e krijuar nga dora e Praksitelit, bëri qmos dhe e grabiti.

Ugolini, «Albania Antica», III, f. 87.

## DISA NGA OBJEKTET E MUZEUT TË VLORËS TË GRABITURA NGA FASHISTËT ITALIANË

### 1. Statujë e një djaloshi, mermer.

Lartësia 2 m, lartësia e bazamentit 0,08 m. Koka e saj u gjet nga Leon Rej me 16 gusht 1926, në kamaren numër tetë të Portikut të Apolonisë. Trupi u zbulua dy ditë më vonë në mes të kamares tetë dhe nëntë. U transportua dhe u ekspozua në fillim në kuotën 104 pranë manastirit të Apolonisë (nga ku ruhet dhe një fotografi e saj), pastaj u dërgua në Muzeumin e Fierit dhe pastaj në Muzeun e Vlorës dhe nga ku u grabit. Kjo statujë (Leon Rej e vendos në shekullin e parë të epokës sonë) paraqet një djalosh të hijshëm. Nën këmbët e tij ndodhet një scrinium, d.m.th. kutia ku ndodheshin të mbështjellat e papiruesit me shkrimet, ndoshta, të djaloshit.

Mjeshtëria me të cilën janë trajtuar palat e robes, fisnikëria dhe përpjestimet e harmonishme e bëjnë këtë skulpturë një kryevepër të antikitetit.

Leon Rej, «Albania», 3, f. 19-21, fig. 12-13; H. Ceka, «Apolonia», Tiranë, 1958, f. 23, foto.

### 2. Objekte të ndryshme qeramike

Këto objekte u zbuluan gjatë viteve 1930-1931 nga Leon Rej në nekropolin e qytetit, në dy pitojë të mëdhenj. Pitosi i parë përmbante këto objekte:



1. Ople me figura të zeza, inçizime dhe sfond të kuq.

2. Ojnohe
3. Skyfos
4. Ojnohe
5. Ojnohe
6. Ojnohe
7. Kothos
8. Kothos
9. Kothos
10. Kothos
11. Krater i vogël.
12. Skyfos i vogël.

Ndërsa pitosi i dytë përmbante një lekyd me figura të zeza. (Gjithsej trembëdhjetë enë me figura nga të cilat opleja, dy ojnohe, një kothos i përkisnin shekullit 7-6, pra ishin të kohës së themelimit të qytetit.) Leon Rej, «Albania», 4, f. 7-27; Hasan Ceka, «Apolonia» 1958, f. 28, 31, 37, foto.

### 3. Objekte të tjera të grabitura:

1. Kokë e një femre, mermer.
2. Kokë e një burri, mermer.
3. Kokë djaloshi, mermer.
4. Skulpturë e Dianës, gur.
5. Statuetë e Afërditës, gur.

Shënim: Lista e inventarit të këtij muzeu është shumë e madhe dhe është e pamundur t'i përmendësh të gjitha. Dihet që muzeu i Vlorës përmbledhte të gjitha objektet e zbuluara nga Leon Rej gjatë 15 vjetëve, sende të ndryshme zbulurimi, fragmente arkitektonike, skulptura, figurina bronzi e balte, monedha e shumë e shumë objekte të tjera.

## OBJEKTE ARKEOLOGJIKE TË HUMBURA, QË DIKUR NDODHESHIN NË PALLATIN E VILHELM VIDIT

1. *Tors i Apolonit, gur gëlqeror, lartësia 0,15 m.*  
«Archeologische forschungen...», f. 40, foto 47  
Leon Rey, «Albania...», 4, f. 100.
2. *Pani dhe tri nimfat, mermer, 0,43, m lartësia, 0,60 gjatësia.*  
«Archeologische forschungen...», f. 41, foto 49; Leon Rey, «Albania...», 4, f. 100.
3. *Bust, mermer.*  
«Archeologische forschungen...», f. 40; Leon Rey «Albania...», 4, f. 102.
4. *Urnë cinerare me inventarin e saj, gur gëlqeror.*  
Brenda urnës ndodheshin këto objekte:  
Një unazë,  
Një byzylyk dore,  
Enë të ndryshme.  
«Archeologische forschungen...», f. 40; Leon Rey «Albania...», 4, f. 104.

*Tabela e shkurtimeve e përdorur në libër në listën e objekteve kryesore të grabitura, të shpërndara sipas muzeumeve.*

1. Mission... — Mission Archeologique de Macedoine par Leon Hezey et H. Daumet, Paris 1876.
2. Das Sand. Berat... — Das Sandschak Berat in Albanien von Carl Patsch, Wien 1904.
3. Leon Rey, Albania... — Albania, revue d'archeologie, d'histoire, d'art et des sciences appliques en Albanie et dans les Balkans.
4. Rev. Arche... — Revue Archeologique.
5. Alb. Stud... — J. G. Hahn Albanesische Studien.
6. Cat. Somm... — Catalogue sommaire des marbres antiques (Musée du Louvre, Paris 1896. Edicioni i dytë është i vitit 1918.
7. Rev. Arch. nouvelle. — Revue Archeologique nouvelle.
8. Melanges... D'Arch.. — Melanges d'Archeologie et d'Epigraphie.
9. Repertoire... Repertoire de la sculpture Grecques et Romaine, I-II, Paris 1909.
10. Souvenirs... A. Degrand, Souvenirs de la Haute Albanie, Paris 1901.
11. Sollomon Reinach, Une necropole... — Sollomon Reinach, Une necropole en Albanie, ne L'Antropologie, Paris 1901.
12. Traeger, Mitheilungen... — P. Traeger, Mitheilungen und Funde aus Albanien, ne Zaitschrift für Ethnologie, 1900.

13. Begrabinis, 1901, — P. Traeger, Bergrabiniss — Platze und Tumuli in Albanien und Macedonien, Verhandlungen der Berliner anthropologischen Gesellschaft, 1901.
14. B.U.SH.T. — Buletini i Shkencave shoqërore, Tiranë.
15. Archeologische Forschungen... — Archeologische Forschungen in Albanien und Montenegro von C. Praschniker und A. Schober, Wien 1919.
16. Balduin Sara, Antiken... — Balduin Sara, Antiken aus Durazzo, ne Jareshefte des Osterreichischen Archeologische Institutes, Wien, 1926.
17. C.I.L. — Corpus inscriptionum latinorum, Berlin 1873.
18. Hequard, Histoire... — Hecquard Hyacinthe, Histoire et description de la Haute Albanie ou Guegarie, Paris 1858.
17. Walters, Catalogue... — H. B. Walters, Catalogue of the bronz of the British Museum, London 1899.
18. G. Mendel, catalogue.. — Mendel, Catalogue des Sculptures Grecques, Romaines et Byzantines, Constantinople 1912.I.
19. Macridy Bey Jarbuch... — Macridy Bey (Th), Jarbuch des Archeologisches Institut, f. 143, XXV, 1910.

## PËRMBAJTJA

Eksplorimi i parë arkeologjik i Shqipërisë .....	3
Pushtimi Osman dhe shkatërrimi barbar i monumenteve të lashtësisë .....	7
Grabitja e muzeve të para .....	18
Përfaqësuesit konsullorë dhe pasioni i tyre i gënjeshtërt i arkeologut amator .....	31
Grabitjet e pasurive arkeologjike të Shqipërisë nga disa austriakë dhe serbë .....	57
Misioni arkeologjik italian, grabitja në masë e pasurive arkeologjike .....	77
Zbulimet arkeologjike nga Leon Rej dhe grabitja e tyre nga fashistët italianë më 7 prill 1939 .....	87
Populli kundërshton grabitjet .....	101
Kronologji .....	114
Listë e objekteve kryesore të grabitura të përmendura në libër e të shpërndara sipas muzeumeve .....	117
Disa nga objektet e Muzeut të Vlorës të grabitura nga fashistët italianë .....	124
Objekte arkeologjike të humbura, që dikur ndodheshin në pallatin e Vilhem Vidit .....	127
Tabela e shkurttimeve .....	128

Ulqini, H.

Grabitës të monumenteve. (Red. P. Tamburi), T., «8 Nëntori», 1980,

132 f.

(B.m.) dhe

(B.v.): 930.26(496.5)(09)

U 41

Tirazhi 10.000 kopje    Format 78x109/32    Stash: 2204-79

KOMBINATI POLIGRAFIK Shtypshkronja e Re —  
Tiranë, 1980